




DIALOGU BEOGRAD – PRISHTINË: NEVOJITET TRANSFORMIM I INTERESIT VETANAK



Vladimir Todoriq

Leon Malazogu

Prishtinë, Beograd

Nëntor 2011

Përmbajtja

Përmbledhje.....	3
Falënderimet.....	4
Terminologjia	4
Kronologjia e Dialogut Teknik	5
Motivet për Dialog dhe pasojat politike	11
Frika dhe perceptimet e Dialogut në Serbi dhe Kosovë.....	13
Çështjet në diskutim	14
Lëvizja e lirë.....	15
Letërnjoftimet dhe targat e makinave.....	15
Diplomat e Universitetit.....	16
Regjistri civil	16
Doganat dhe kadastra.....	17
Tregtia e lirë dhe vulat doganore.....	18
Nga grindja tregtare në barrikada.....	19
Analizë e fitimeve dhe humbjeve që nga marrëveshja e parë	22
Çfarë është ‘normalizimi’?	26
Kushtëzimi bilateral	29
Rreziqet në horizont.....	31
Çfarë mund të pengojë akoma dialogun në të ardhmen?.....	32
Beteja për një garë bukurie: BE-ja është juria	33
Besimi reciprok dhe kredibiliteti.....	34
Mbajtja e hapit.....	36
Transformimi i interesave vetanake: Nga shuma-zero në interes reciprok	36
Skenarët	37
Rekomandime	39

Përmbledhje

Përderisa Kosova dhe Serbia kanë biseduar shumë herë në të kaluarën, kjo është hera e parë që ato pajtohen drejtpërsëdrejti (pesë marrëveshje tanimë janë arritur). Përkundër të metave dhe pakënaqësive, nëse realizohen, këto marrëveshje fillestare do ta bënin këtë proces historik. Se a do të sjellin rezultate të qëndrueshme, varet nga faza e ardhme dhe nëse të dy palët mund të pretendojnë që i kanë shërbyer interesit të tyre dhe njëherit duke bashkëpunuar me palën tjetër.

Ky proces ka kaluar nga bisedime teknike në mosmarrëveshje tregtare dhe ka eskaluar në kontest të hapur. Secila palë ende percepton se përfitimet mund të vijnë vetëm me humbjen e palës tjetër. Interesi shtetëror me shkurtpamësi përcaktohet si dobësim i interesit të palës tjetër. Qëllimi i këtij studimi nga Qendra për Politikë të Re (NPC) nga Beogradi dhe Projektit për Marrëdhënie Etnik (PER-K) nga Prishtina është që të dëshmojë që të dy shtetet duhet të realizojnë interesat e tyre duke ndihmuar njëra tjetrën që të bëhen funksionale. Edhe pse ky proces mbetet i papëlqyer, ne besojmë se të dy palët varen nga njëra tjetra për zgjedhjen e problemeve (dhe si të tilla gjenden në një varkë), por akoma nuk e kanë kuptuar një gjë të tillë.

Sekreti i një dialogu zakonisht fshihet në zënien e momentit të duhur. Koha nuk është asnjëherë e duhur dhe duhet shfrytëzuar dritaren sado pak të hapur. Ajo mundësi e vogël që solli Serbinë dhe Kosovën më afër është shpejtë duke u mbyllur, me një sërë faktorësh të rrezikut që vërehen në horizont e që mund të dëmtojnë afrimin e mëtejshëm: (a) mundësia që Serbia të organizojë zgjedhje në veri, (b) mungesa e unitetit në BE, (c) mungesa e zbatimit të marrëveshjeve të arritura dhe mospërfshirja e çështjeve tjera shtesë në dialog (bashkëpunimi rajonal, telekomunikacioni, energjia, kufiri i integruar/menaxhimi i kufirit), (d) ulja e kriterëve të kushtëzimit bilateral, apo (e) nëse karotat e BE-së shihen nga ndonjëra anë si shpërblime asimetrike në përputhje me performancën e tyre.

Dialogu duket si një garë bukurie. Negociatorët nuk angazhohen seriozisht në dialog, por apelojnë tek Bashkimi Evropian për bashkëndjesi dhe reagojnë ndaj presioneve. Publikisht, Kosova dhe Serbia paraqiten se po vazhdojnë betejat e tyre shekullore por kësaj here me finesë diplomatike. Brenda dhe jashtë dhomës së negociatave, bisedimet i ngjajnë përzgjedhjes së një misi ku garuesit fokusojnë përpjekjet kryesore në ndikimin e vlerësimit të ndërmjetësit të jashtëm se cila palë ka qenë më 'konstruktive'. Tendencat populiste paraqesin dialogun si një arritje fitimtare e menjëherësh mbi palën tjetër që mund të përmirësojë profilin e politikanëve të angazhuar, por mund të dëmtojë kredibilitetin e tyre dhe të vështirësojë arritjen e marrëveshjes në raundet pasuese. Në këtë fazë është me rëndësi të mos humbet hapi – përkundër disa hapave prapa, në fund të fundit është më mirë të kemi bashkëpunim jo plotësisht të sigurtë se sa konflikt të sigurtë.

Është me rëndësi të ekzaminohen hollësisht përfitimet dhe humbjet e secilës palë. Aktualisht, siç qëndron në letër, përfitimet e llogaritura janë më të mëdha se humbjet. Ky dialog ka nxitur Kosovën dhe Serbinë që të thonë çfarë pritet nga ta, të duken pro dialogut, mirëpo Serbia dhe Kosova ende perceptojnë që është në interesin e tyre që pala tjetër të jetë sa më e dobët që është e mundur. Përderisa Serbia shihet si kërcënim nga Kosova dhe anasjelltas, të dy palët do të shohin fuqizimin e tyre vetëm në raport të dobësimit të 'armikut'. Kjo pamje jo vetëm se do të shpenzojë resurse të vlefshme në mënyrë joefikase, por do të parandalojë edhe reformin dhe transformimin e shoqërive drejt vlerave evropiane.

Serbisë nuk do të fitojë statusin e kandidatit nëse nuk fillon shpërbërjen e disa nga 'strukturat paralele' në veri të Kosovës dhe të normalizojë marrëdhëniet me Kosovën. Nëse këto dy kushte përmbushen, të dy vendet do të mund të hapin rrugën për të ardhmen evropiane. Nëse 'normalizimi' arrihet në javët e fundit para 9 dhjetorit, Serbisë mund ti jepet statusi i kandidatit përderisa Kosovës mund ti jepet liberalizimi i vizave dhe marrëdhëniet kontraktuale me BE-në. Kosova nuk fiton asgjë nëse Serbia ndalohet në integrimin e saj evropian por do të humbiste nëse Serbia humb interesin për të prodhuar rezultate në rrugën drejt 'normalizimit'. Fatkeqësisht, normalizimi nuk vjen vetvetiu, por ndodh nga kushtëzimi i fuqishëm nga shtetet anëtare të BE-së.

Progresi asimetrik mund të kërcënojë të dy vendet, pasi që koncepti ‘i një varke’ do të pushtonte së aplikuari. Është thelbësore që përmes politikave të jashtme, BE-ja të thellojë kuptimin që të dy palët janë në të njëjtën varkë; prandaj shpuarja e vrimave në një rën anë do të fundoste të dy. Në mënyrë që ky mesazh të jetë efektiv, vlerësimi i BE-së duhet të jetë i njëtrajtshëm.

Natyra e mbyllur e procesit ka rezultuar në ndërtim konsensusi minimal dhe një “mentalitet-bunker” me rezistencë për të zbatuar marrëveshjet e arritura. Dialogu aktual duhet të adresojë marrëdhëniet në mes të Prishtinës dhe Beogradit, përderisa Prishtina duhet të hapë kanal komunikimi me serbët e veriut të Kosovës.

Falënderimet

Qendra për Politika të Reja (NPC) dhe Projekti për Marrëdhënie Etnike – Kosovë (PER-K) falënderojnë Ambasadën Britanike në Beograd dhe Prishtinë si dhe krye-negociatorët e të dyja ekipeve për qasjen e hapur të tyre në këtë punim. Po ashtu falënderojmë edhe disa analistë për pjesëmarrjen e tyre në konsultimet tona ose për gatishmërinë për të komentuar draftet e para të këtij punimi. Dëshirojmë të veçojmë këtu Alex Grigor’ev (Kryetar nga Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse), Engjëllushe Morinë (Drejtoreshë Ekzekutive pranë Institutit Kosovar për Stabilitet), Agron Bajrami (Kryeredaktor i gazetës Koha Ditore), Boshko Jakshiq (Redaktor i seksionit të politikave të jashtme të së përditshmes beogradase ‘Politika’) si dhe Vladimir Paviceviq (Profesor në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd). Përgjegjësia e përmbajtjes së punimit mbetet ekskluzivisht tek autorët.

Terminologjia

Kur referohen serbët e Kosovës për nga lokacioni, punimi i referohet ‘serbëve të veriut’ ata që jetojnë në katër lokacionet me shumicë serbe në veri, dhe ‘serbët qendrorë’ për serbët në pjesët tjera të Kosovës. Punimi përdor shkronjën ‘D’ të madhe për ‘Dialog’ për të dalluar procesin e tanishëm me dialogun si koncept në përgjithësi.

Projekti është përkrahur nga Ambasada e Britanike në Prishtinë dhe Beograd.

E drejta e autorit 2011 © Vladimir Todoriq, Leon Malazogu, Qendra për Politika të Reja, Projekti për Marrëdhënie Etnike – Kosovë.

Qëndrimet e shprehura në punim jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

Kronologjia e Dialogut Teknik

- Shtator 2010 – Takimi Ashton-Tadiq në Nju Jork ka shpjer tek miratimi i rezolutës së përbashkët Serbi-BE-OKB e cila solli Dialogun e ndërmjetësuar nga BE
- Tetor 2010 – Kosova hyn ne krizë institucionale – Shpallen zgjedhjet
- Dhjetor 2010 – Zgjedhjet parlamentare në Kosovë
- 23 shkurt – Formimi i qeverisë së Kosovës
- 8 mars – Dialogu fillon
- 12 maj – Borislav Stefanoviq viziton Prishtinën dhe zhvillon biseda zyrtare
- 2 korrik – Tri marrëveshjet e para arrihen në mes të Beogradit dhe Prishtinës mbi lëvizjen e lirë të personave, targar e automjeteve, regjistrat civil, diplomat universitare
- 15 korrik – Vazhdimi i bisedimeve në raundin e dytë shtyhet për shtator
- 20 korrik – Prishtina vendos masat e reciprocitetit për embargon tri vjeqare të Serbisë mbi mallrat e Kosovës pasi që Beogradi nuk i kishte njohur vulat doganore të Kosovës
- 25 korrik – Prishtina dërgon njësitet policore në Pikat 1 dhe 31 (pikat doganore në Jarinjë dhe Brnjak) për të zbatuar masat e reciprocitetit. Një polic u qëllua për vdekje. Beogradi dërgon krye- negociatorin Borislav Stefanoviq në veri të Kosovës për të negociuar në emër të serbëve të Kosovës me KFOR- in
- 27 korrik – Pikat doganore të Kosovës digjen nga protestuesit serbë
- 29 korrik – Borislav Stefanoviq dhe komandanti i KFOR-it Erhard Buhler arritën një marrëveshje të përkohshme deri me 15 shtator për pikat doganore dhe vendkalimet kufitare
- 2 shtator – Fillon raundi i ri i Dialogut. Arrihet marrëveshje mbi vulën doganore dhe çështjet e kadastrit. Raundi i ri planifikohet për 28 shtator
- 16 shtator – Me ndihmën e EULEX-it dhe KFOR-it, Qeveria e Kosovës dërgon zyrtarët doganorë në Pikat 1 dhe 31. Serbët lokal reagojnë duke vënë barrikada në rrugët e veriut të Kosovës
- 27 shtator – Në pikën doganore në Jarinjë ndodhin incidente përfshirë të shtëna në mes serbëve lokal dhe KFOR-it. Njëmbëdhjetë persona lëndohen, prej të cilëve shtatë serbë dhe katër ushtarë të KFOR-it
- 28 shtator – Raundi i ri i Dialogut gati për të filluar. Pala serbe kërkon bisedime për pikat doganore të cilat u refuzuan nga Prishtina dhe negociatori i BE-së Robert Cooper. Beogradi refuzoi të bisedojë për çështjet tjera duke konsideruar incidentet në Jarinjë si prioritet. Dialogu u ndërpre pa mbajtur asnjë mbledhje
- 7 dhe 8 tetor – Negociatori i BE-së Robert Cooper viziton Beogradin dhe Prishtinën duke u përpjekur të arrijë një kompromis për të vazhduar Dialogun. Asnjë marrëveshje nuk u arrit pasi që Beogradi kërkoi që sërish të bisedohet për pikat doganore, ndërsa Prishtina refuzoi bisedimet për punët e brendshme
- BE publikoi Mendimin për kandidimin e Serbisë dhe publikoi udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. BE-ja insistoi në ri-angazhimin e Serbisë në Dialog si kusht për kandidaturë
- 19 tetor – Kryetarët e komunave serbe njëzëshëm refuzojnë të zbatojnë çfarëdo marrëveshje që Beogradi kishte arritur me Prishtinën në Dialog. Për më tepër, ata refuzuan të bashkëpunojnë me EULEX-in dhe kërkuan ri-angazhimin e UNMIK-ut. Barrikatat mbesin.
- 27 tetor – Barrikatat largohen pjesërisht. Serbët e Kosovës largojnë barrikatat në baza selektive në mënyrë që vetëm KFOR-i të mund të lëvizte lirshëm në tërë veriun e Kosovës, por jo edhe për EULEX-in.
- 21-22 - nëntor – Raundi i ri i Dialogut. U arrit marrëveshja për njohjen e diplomave. Gjithashtu, u zhvilluan bisedimet edhe për menaxhimin e integruar të kufijve, por pa rezultat.

Pritet:

- Janar-prill – Fushata zgjedhore në Serbi. Disa procese të Dialogut mund të vazhdojnë po nuk pritët ndonjë marrëveshje.
- Maj-qershor – Zgjedhjet dhe krijimi i qeverisë së re.
- Shtator – Normalizimi i plotë, kushtëzim i kërkuar nga Mendimi i Komisionit Evropian për Kandidaturën e Serbisë.
- Çdo hap i vogël i Serbisë do të kushtëzohet për më shumë hapa drejt normalizimit me Kosovën dhe strukturë e ngjashme stimuluese do të aplikohet edhe për Kosovën
- Diplomacia fluturuese do të vazhdojë të trajtojë çështje tjera të vështira.

Qëllimi i studimit: Nga shuma zero të bashkëpunimi

Ky studim fillon me një analizë të historikut të dialogut, pastaj shqyrton fitimet dhe humbjet e të gjitha palëve dhe përpqet të kuptojë se çfarë kërkon BE-ja me fjalën 'normalizim'. Frika dhe rezistenca publike për dialog është analizuar në mënyrë që të përcaktohet shkalla e arsyeshmërisë së frikës. Pas një përshkrimi analitik të procesit, punimi shqyrton se çfarë ka ndodhur me besimin e ndërsjellë, kredibilitetin dhe përshkruan katër skenare të mundshme. Mbi të gjitha, përpqet që të vlerësojë shkallën që mosmarrëveshjet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë një 'lojë me shumën zero' (që njëra palë të fitojë, tjetra medoemos duhet të humbas). Përfundimisht, sugjerohen disa rekomandime se si të arrihet tek një përfundim fitim-fitim që është edhe qëllimi kryesor i këtij analize.

Mund të mos pëlqehet, por të dy palët janë në të njëjtën varkë të problemeve, por ende nuk e kanë kuptuar këtë.

Secila palë ka një perceptim se fitorja vjen vetëm me humbjen e palës tjetër. Interesi shtetëror me shkurtpamësi përkufizohet si dobësim i interesit kombëtar të palës tjetër. Qëllimi i këtij studimi, nga Qendra për Politika të Reja (CNP) nga Beogradi dhe Projektit për Marrëdhënie Etnike në Kosovë (PER-K), është të vërtetojë se ky pretendim nuk qëndron dhe se të dy vendet duhet të realizojnë interesin e tyre duke ndihmuar që pala tjetër të jetë funksionale. Mund të mos pëlqehet, por të dy palët janë në të njëjtën varkë të problemeve, por ende nuk e kanë kuptuar këtë. Ky studim përqendrohet tërësisht në të ardhmen, paraqet skenarët dhe rekomandon se si ata mund të sigurojnë që ky transformim vërtetë të ndodhë.

Studimi është nxitur nga pyetja kërkimore e mëposhtme: Çfarë procesi është ky dialog, dhe a mund të japë një rezultat që të dy palët përfundimisht do ta praninin? Kjo nuk është hera e parë që një konflikt duket i vështirë, por historia tregon se shumë vende të cilat iu nënshtruan luftërave të ashpra tani janë aleatët më të mëdhenj dhe udhëheqin tjerët drejt një bashkëpunimi dhe prosperiteti.

Si mund ta dimë se kemi pasur sukses? A munden bisedimet 'të shtjerrin' mosmarrëveshjet për statusin?

Shpesh është thënë se sukcesi do të matet me shkallën se sa të dyja palët janë në gjendje ti komunikojnë publikut të tyre se ata kanë fituar. Megjithatë, PER-K dhe CNP besojnë se rezultatet e mjegullta nuk duhet të kenë besimin e të dy palëve, në qoftë se çmimi i kërkesave të tilla do të thotë fshehja e detajeve të rëndësishme nga publiku. Ndërmjetësimi nuk duhet të jetë vetëm një menaxhim i pritjeve të publikut, por ndihmesë për transformim thelbësor ku Serbia dhe Kosova gradualisht fillojnë të besojnë në marrëdhënie të dobishme të ndërsjella.

Ndërmjetësimi nuk duhet të jetë vetëm një menaxhim i pritjeve të publikut, por ndihmesë për transformim thelbësor ku Serbia dhe Kosova gradualisht fillojnë të besojnë në marrëdhënie të dobishme të ndërsjella.

Studimi përfundon se bisedimet janë të nevojshme, dhe ato duhet të vazhdojnë me çështje teknike (jo për status) siç është planifikuar. Duhet bërë më shumë për të arritur më të mirën që është e mundshme. Duke pasur parasysh peshën e kujdesshme dhe kontekstin e duhur, bashkëpunimi mund të jetë i mundshëm në një numër më të madh të temave sesa që janë diskutuar deri më tani.

Kufizimet aktuale

Serbia nuk e njeh Kosovën dhe është e padobishme të pritët se kjo mund të ndryshojë shpejtë. Në të njëjtën kohë, Kosova ka shpallur pavarësinë e saj dhe nuk i bie ndërmend të braktisë konsolidimin e mëtutjeshëm të shtetit. Dialogu i tanishëm nuk mund të synojë më shumë se sa përmirësimin e situatës dhe arritjen që Beogradi dhe Prishtina të realizojnë interesin e tyre të përbashkët brenda kufizimeve të dhëna. Qasja e vetme e mundshme ishte pranimi i kufizimeve të ty dyja palëve (mosnjohja e Kosovës nga Serbia dhe vendosmëria e Kosovës për sovranitet) dhe të shfrytëzohet

hapësira në mes më së mirë që mundet. Pyetja thelbësore të cilës punimi përpiqet t'i përgjigjet është: Çfarë përparimi mund të bëhet pa i kërkuar Serbisë të njohë Kosovën dhe duke mos i kërkuar Kosovës të tërhiqet nga konsolidimi i statusit të saj?

Shpesh dëgjohet se zgjidhje kreative që janë duke u kërkuar mund të përmirësojnë jetën. Njëra nga kritikantët fillestare të procesit ishte fakti se nuk i kontribuon zgjidhjes së statusit. Por nuk ka ndonjë arsye pse ky dialog nuk duhet të bëhet vetëm sepse nuk ka shumë të bëjë me statusin. Kjo nuk e forcon statusin e Kosovës, por as që e dobëson atë.

Joshja nga 'kulaçi i rritur' evropian

Serbia dhe Kosova mund të kenë interpretime të ndara të historisë së ndërsjellë, pretendime kundërthënëse për territor të njëjtë; dhe deri sot ato vazhdojnë të dallojnë dhe të ushqejnë konflikt të bazuar mbi interesat përkatëse afatshkurta. Mund të mos jetë e dukshme për shumë vetë në Serbi dhe Kosovë, por Serbia dhe Kosova kanë një qëllim të përbashkët që duhet të mbizotërojë të gjitha qëllimet e tjera. E ardhmja evropiane duket shpesh një klishe ose një qëllim i largët, por e ka dëshmuar se ka fuqinë për të transformuar interesin vetjak dhe të rrisë "kulaçin" në mënyrë që mospajtimet e sotme të duken të vogla kur të vështrohen nga e ardhmja.

Çfarë përparimi mund të bëhet pa i kërkuar Serbisë të njohë Kosovën dhe duke mos i kërkuar Kosovës të tërhiqet nga konsolidimi i statusit të saj?

Perspektiva evropiane e ka fuqinë për të shtyrë reforma gjithëpërfshirëse politike, ekonomike dhe sociale e lëre më që të ndihmojë në tejkalimin e mosmarrëveshjeve fqinjësore. Qasja afatgjate drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes Serbisë dhe Kosovës është në fakt dy-kahore: prek prioritetet afatgjata shoqërore si dhe kontestet specifike ndërmjet dy shteteve. Në fund të fundit, joshja nga integrimi evropian duhet të mobilizojë shtresën e mesme punëtore si shtytës kryesor të reformave, paqes dhe demokracisë.

Procesi i dialogut është një mundësi historike për Beogradin dhe Prishtinën për të bërë një hap përpara në bashkëpunim. Mund të jetë një mendim i dëshirueshëm, por dialogu "nuk ka mundësi mos të ketë sukses" meqë bashkësia ndërkombëtare duket gjithnjë e më e vendosur për t'i shtyrë ato drejt një bashkëpunimi. Edhe pse me sfida të shumta, dialogu i tanishëm ka fuqinë, dhe tashmë ka filluar, të shohë ndikimin evropian duke u përdorur për të transformuar mënyrën si e trajtojnë Beogradi dhe Prishtina njëra tjetrën dhe të riformulojnë interesat e tyre dhe të bëjë bashkëpunimin të dobishëm. Pas marrëveshjes së pasuksesshme të St. Egidios (OJQ italiane) në vitet e nëntëdhjeta, Kosova dhe Serbia nuk kanë pasur marrëveshje tjera.

Sa larg mund të na shpie ky dialog?

Shpesh thuhet se koha prodhon miqësi por nëse do t'i lihej vetëm kohës, kjo do të zgjaste shumë më tepër se sa kosovarët dhe serbët janë të gatshëm të presin. Koha është vetëm e rëndësishme nëse ndikohet nga katalizatorë që përshpejtojnë ndryshimin e interesit vetanak. Shumica e serbëve dhe kosovarëve e ndjejnë se konflikti ka ngrirë të ardhmen e tyre përderisa s'ytë e tyre janë shikojnë drejt Evropës. Shumë thonë se momenti nuk është i përshtatshëm dhe se është shumë herët të tejkalohet ndarja. Por çdo kimist do të sugjeronte se reaksioni mund të përshpejtohet me katalizatorët e duhur. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë janë katalizatorët e tanishëm që përshpejtojnë periudhën e transformimit.

Ekziston një frikë se dialogu i tanishëm mund të mos prodhojë progres të mjaftueshëm për të mobilizuar publikun për bashkëpunim. Disa vonesa në implementimin e Dialogut, mospajtim për detaje të vogla dhe minimi i palës tjetër mund të zvogëlojnë fuqinë e dialogut. Është thelbësore që të ndihmohen të dyja palët për të kuptuar mundësinë e përfitimit dhe çmimin e mosveprimit.

Më shumë gjithëpërfshirje për efekte më të gjata

Përfshirja më e madhe mund të duket sfiduese tani dhe mund të vonojë shumë marrëveshjet për çdo çështje. Megjithatë, marrëveshjet gjithëpërfshirëse pritet të zgjasin më tepër. Me këtë

përshtypje, studimi argumenton se shoqëria civile dhe Kuvendet e të dyja vendeve duhet të përfshihen. Ky bashkëpunim dhe gjithëpërfshirja mund të jenë më frytdhënëse pasi të vërehen efektet e marrëveshjeve të para. Nëse zbatohet si duhet, qarkullimi i mallrave dhe njerëzve do të ketë ndikim pozitiv në opinionin publik. Për efekt afatgjatë, është e rëndësishme që marrëveshjet mos të abuzohen për qëllime politike afatshkurta.

Efektet e përfitimeve mund të përhapen shpejtë në elita si të intelektualëve, politikanëve, rinisë dhe sportistëve. Kur të shihet si ‘cool’, bashkëpunimi mund të përhapet dhe do të bëhet model siç është në botën demokratike. Marrëveshjet mund të duken të mrekullueshme por progresi është i pamundur nëse bashkëpunimi e nxjerr dikë si tradhëtar. Sfida nuk është e vogël – kërkon ndryshim të paradigmes për të cilën parakusht është që njerëzit të sigurohen se Dialogu nuk është kërcënim për asnjërin nga shtetet. Për shembull, kosovarët frikësohen shumë se bashkëpunimi i tyre mund të ndihmojë Serbinë të marrë statusin e kandidatit, pa i dhënë Kosovës përfitime adekuate. Një rezultat i tillë i pabalancuar mund të eliminojë kuptimin e ‘një varke’, dhe Serbia mund të vazhdojë të pengojë progresin e Kosovës dhe në të njëjtën kohë të lëvizë drejt integritimit evropian pa pengesë. Një situatë asimetrike do të pasonte me efekt të rënies të ndikimit të BE-së tek palët biseduese.

Konteksti

Bashkimi Evropian ka inicuar procesin e dialogut në fund të vitit 2010 dhe ka filluar në mars të 2011 në mes qeverive të Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet synonin të normalizonin gjendjen e vështirë që zgjati që nga *Deklarata e Pavarësisë* në shkurt të vitit 2008. Përgjatë kësaj kohe, Serbia ndoqi politikën e bllokimit të anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe ruajti praninë në veri të Kosovës. Kushtëzimi nga Serbia dhe disa vende anëtare të Këshillit të Sigurimit penguan njohje të reja për Kosovën dhe anëtarësimin e saj në OKB. BE-ja dhe kushtëzimi i dyanshëm penguan Serbinë nga marrja e kandidaturës për në BE.

Nëse zbatohet si duhet, qarkullimi i mallrave dhe njerëzve do të ketë ndikim pozitiv në opinionin publik. Është e rëndësishme që marrëveshjet mos të abuzohen për qëllime politike afatshkurta.

Disa vende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës për shkak të mbështetjes së tyre për Serbinë dhe të tjerat për konsiderata të tyre të brendshme. Mosnjohja nga pesë shtetet anëtare të BE-së ka penguar BE-në për t’i ofruar Kosovës perspektivë të qartë për liberalizimin e vizave dhe Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit. Vazhdimi i izolimit të Kosovës mund të reflektojë me radikalizim politik që mund të ketë pasoja të dëmshme në marrëdhëniet me Serbinë, komunitetin serb në Kosovë dhe marrëdhëniet rajonale.

Serbia padyshim është e bllokuar në të ardhmen e saj në drejtim të BE-së, si në kuptim të progresit formal ku është e kushtëzuar me “normalizimin e marrëdhënieve” me Kosovën ashtu edhe për faktin se reformat e brendshme janë të kufizuara nga përqendrimi politik dhe ekonomik drejt Kosovës. Përderisa Serbia ka shfrytëzuar periudhën prej shkurtit të vitit 2008 të ndjekë politikën e saj “BE dhe Kosova”, Qeveria në Beograd ishte ballafaquar me një porosi të qartë nga Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel dhe zyrtarët e BE-së në Opinionin e Komisionit. Për ofrimin e kandidaturës, Serbisë nuk do t’i ofrohet statusi kandidat derisa ajo nuk fillon me shpërbërjen e “institucioneve paralele” në veri të Kosovës, dhe të normalizojë marrëdhëniet me Kosovën.

Historiati i Dialogut

Pasi Kosova shpalli pavarësinë e saj në shkurt të vitit 2008 Serbia hyri në një varg mosmarrëveshjesh me vendet që e mbështesin pavarësinë e Kosovës. Menjëherë pas pavarësisë së Kosovës, në koalicionin e DS-DSS (Tadiq-Koshtunica) u shfaqën çarje të mëdha. Dallimet përqendroheshin në masat e marra në përgjigjen e Serbisë drejt njohjes së Kosovës dhe në atë nëse Serbia mundet të ndalojë Integrimin e saj evropian.

Versionet e ‘lehta’ të kundërshtimit të pavarësisë së Kosovës nënkuptonin tërheqjen e ambasadorëve serbë në Beograd për një kohë të pacaktuar të konsultimeve dhe angazhimit e

mekanizmave të OKB-së për të kërkuar një mendim mbi ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND-ja). Masat më serioze mbështetur nga DSS-ja ishin të ndërpriten marrëdhëniet diplomatike me vendet që e njohën pavarësinë e Kosovës dhe ngritja e padive ndaj tyre para GJND-së.

Rënia e Qeverisë serbe në mars të vitit 2008 u pasua me një mbështetje të fortë të BE-së për Partinë Demokratike dhe Boris Tadiqin, që rezultoi me nënshkrimin e MSA-së në prill të atij viti dhe ndihmën joformale gjatë formimit të Qeverisë së re në qershor. Pas kësaj, Qeveria e re serbe filloi një të ashtuquajtur “Qetësim të Lehtë”, fazë e cila ishte drejtuar nga politika “edhe BE edhe Kosovë”. Kjo politikë nënkuptoi që Serbia do të normalizonte plotësisht marrëdhëniet diplomatike me vendet që e njohën Kosovën, edhe pse fërkime u rishfaqën pas çdo njohje të mëvonshme të Kosovës.

Serbia vendosi lidhje zyrtare me EULEX-in, por njëkohësisht arriti të bllokojë zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin (përmendur shpesh si pakoja e Ahtisaarit), në veri të Kosovës. Serbia bëri çdo gjë të mundshme për të penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare si OKB, OSBE, KE dhe në shumë organizma tjerë jo politik (ITU, FIFA, etj.). Kjo politikë u tolerua nga BE nga qershori i 2008 deri në korrik të 2010, kur i arratisuri i fundit i Tribunalit u arrestua nga autoritetet serbe dhe u transferua në Hagë. Çështja e Kosovës mbeti pengesa e vetme në rrugën e Beogradit në integrimin e mëtejshëm në BE.

Gjatë kësaj periudhe Serbia arriti të fillojë procedurën në dhënien e mendimit nga GJND-ja për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës e cila zgjati për gati dy vjet (nga shtatori 2008 deri në korrik 2010) dhe e cila pengoi një numër të konsiderueshëm të vendeve të njohin Kosovën. Megjithatë, edhe pasi GJND-ja dha mendimin e vet pozitiv për pavarësinë e Kosovës, të tjera sfida penguan Prishtinën për të bërë hapa zyrtar për në BE si bisedat për Liberalizimin e vizave apo MSA.

Beogradi u zhgënjye me opinionin e Tribunalit, por as ky opinion nuk e hapi rrugën për një valë të re njohjesh. Beogradi fillimisht u përpoq të miratonte një rezolutë në OKB e cila do të mund të zvogëlonte ndikimin e mendimit të GJND-së, por u përball me një mesazh shumë të fuqishëm nga disa anëtarë me ndikim të BE-së, si Britania e Madhe¹ dhe Gjermania². Ministritë e jashtme të të dy vendeve vizituan papritur Beogradin në gusht të viti 2010 dhe publikisht thanë se nëse Beogradi tenton të kontestojë draft-rezolutën, i gjithë procesi i integritit të Serbisë mund të bllokohet. Ky moment shënon ndarjen e parë të heshtur të fuqive të mëdha perëndimore me politikën e Beogradit “të BE-së dhe Kosovës”.

Zyrtarët ndërkombëtarë nuk insistojnë që Beogradi të njohë zyrtarisht Kosovën, por presin shpërbërjen e disa strukturave të saj paralele në veri të Kosovës dhe normalizimin e marrëdhënieve me Prishtinën.

Opinionin e GJND-së solli një pikë kthese në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në shtator të 2010 kur Serbia ndryshoi projektligjin e saj të parë për të shkruar një të përbashkët me de facto ministrin e jashtëm të BE-së, znj.

Catherine Ashton³. Kjo shpesh është cituar si një pikë kthese në politikën e Serbisë ndaj Kosovës, sepse ajo paralajmëroi një proces dialogu në mes Prishtinës dhe Beogradit. Humbja e Serbisë në GJND dhe mesazhet e ashpra i shtynë drejt një ndryshimi në qasje dhe politikë. Rezoluta e përbashkët e OKB-së e vënë bashkërisht nga BE-ja dhe Serbia ndikoi në mundësimin e transferimit të politikës së “zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” nga organet e OKB-së (Këshilli i Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme, dhe GJND-ja) në Institucionet e Bashkimit Evropian. Asambleja e Përgjithshme, dhe GJND-ja në institucionet e Bashkimit Evropian. Një raund i ri i mesazheve të ashpra erdhën në Serbi në të njëjtën kohë të vitit të 2011, këtë herë nga ana e Kancelares Gjermane, Angela Merkel dhe

¹ B92. 1 shtator 2011. Cilat janë porositet e William Hague.

http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2010&mm=09&dd=01&nav_id=455562.

² B92. Vestervele. Harta ndryshon gjithnjë.

http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2010&mm=08&dd=26&nav_id=454255.

³ Përfaqësuesi i lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë.

Presidenti i Bashkimit Evropian, Herman Van Rompuy. Zyrtarët ndërkombëtarë nuk insistojnë që Beogradi të njohë zyrtarisht Kosovën, por presin shpërbërjen e disa strukturave të saj paralele në veri të Kosovës dhe të normalizimit të marrëdhënieve me Prishtinën.

Pas mendimit të GJND-së dhe Rezolutës së OKB-së në gusht-shtator 2010, ishte e pamundur të pretendohet se procesi i integritimit Evropian dhe politika e Kosovës janë të ndara. Ata mundnin të bënin këtë para kësaj gjendje sepse shtetet e BE-së e pranonin që forcave pro-BE në Serbi u nevojitej kohë për tu konsoliduar pas zgjedhjeve të majit 2008 – një ‘grejs periudhë’ që përfundoi kur Serbia refuzojë të pranojë mendimin e GJND-së dhe vazhdojë me një rezolutë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Disa vende të BE-së e panë këtë pothuajse si një akt armiqësor nga Serbia.

Prishtina ishte e zënë e papërgatitur gjatë mendimit të GJND-së, dhe brenda disa muajve, koalicioni qeverisës u shpërbë dhe kjo dërgoi në zgjedhje të hershme. Pas gati gjashtë muajsh procesi zgjedhor të vështirë dhe bllokimi politik (që zgjati nga mesi i tetorit e deri në fund të arsit), Kosova më në fund formoi një koalicion të ri qeverisës të udhëhequr nga kryeministri më parë në pushtet, Hashim Thaçi. Ai ia doli të hyjë në koalicion me biznesmenin kundërthënës, Behxhet Pacolli, dhe të gjitha bashkësitë pakicë për të siguruar mandatin e dytë në detyrë. Gjatë kësaj periudhe, një raport i përpiluar nga raportuesi i Këshillit të Evropës Dick Marty sugjeroi që ish-udhëheqësit kryengritës shqiptar të Kosovës, përfshirë Thaçin, kanë qenë të përfshirë në trafikimin e organeve njerëzore dhe armëve si dhe aktiviteteve tjera ilegale gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë. Raporti famëkeq i Marty-it u publikua gjatë kësaj periudhe, përderisa pritjet u rritën për arrestimin e personit numër dy në zinxhirin komandues, Fatmir Limaj.

Gjykata Kushtetuese erdhi në përfundim vitin e kaluar që Presidenti i atëhershëm, Fatmir Sejdiu, kishte shkelur kushtetutën duke mbajtur udhëheqjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në të njëjtën kohë. Ky vendim shtyri Sejdiun në dorëheqje që u pasua me vendimin e partisë së tij për të braktisur koalicionin qeverisës që solli tek zgjedhjet e hershme. Partia e Pacollit vendosi të përkrahë Hashim Thaçin në shkëmbim të postit të Presidentit për liderin e kësaj partie. Pacolli u zgjodh president vetëm në raundin e tretë të votimit në Kuvend me një shumicë të thjeshtë pasi që dështoi të fitojë dy-të-tretat e votave të nevojshme në raundet e mëhershme. Zgjedhja e Pacollit president ishte deklaruar si jo-ligjore nga Gjykata Kushtetuese që e detyroi edhe atë të lëshojë postin.

Ky koalicion me shumicë të ngushtë la në opozitë tri grupe të mëdha shqiptare të Kosovës. Partitë tjera kryesore të përfaqësuara në Kuvend refuzuan të bashkëpunojnë me Thaçin duke e akuzuar atë për korrupsion dhe keqmenaxhim. Procesi zgjedhor përjetoi një nivel të paparë të shkeljeve, ndërsa përfaqësuesit ndërkombëtar në Prishtinë vazhdimisht bënin thirrje për një qeveri “me duar të pastra”.

Përpos periudhës së trazuar brenda Kosovës, shumica e deklarimeve nga BE-ja u përqendruan në dialog të cilin kosovarët e shihnin si kohën më të përshtatshme për ta shtyrë Prishtinën në një proces të dëmshëm. Aftësia e Kosovës për tu kundërpërgjigjur apo angazhuar në proces u pengua seriozisht nga mungesa e legjitimitetit të përfaqësuesve dhe dëmtimi i kredibilitetit të tyre në nivel ndërkombëtar. I gjithë ky proces kaloi nën hijen e diplomacisë agresive të Serbisë dhe sfidën e parë të një projekti të madhe të Zonjës Ashton që nga themelimi i zyrës së saj.

Procesi i dialogut u ballafaqua me probleme serioze shumë para se ai të fillojë. Pasi marrëveshja për dialog doli nga shkëmbimet e Serbisë me BE-në (takimeve të Tadiqit me Ashton), ishte e qartë se Kosova nuk ishte e përfshirë nga fillimi. Reagimet nga Prishtina ishin nga ato negative tek ato të përziera për shkak të mungesës së pronësisë së procesit, por edhe për shkak se u perceptua si një aventurë e rrezikshme dhe me mungesa të stimulimeve.

Krye-negociatori i Serbisë shpesh ka apeluar në metodën ‘humanitare’, pastaj e kombinon me interesin e Serbisë për integrim evropian dhe në fund përdor argumentin që Dialogu mund të jetë një mënyrë për bisedimin e çështjeve që lidhen me statusin.

Pozita e Beogradit vazhdonte të ishte e paqartë. Beogradi mbante qëndrimin se nuk do ta njohë Kosovën në asnjë mënyrë, edhe pas shtatorit të viti 2010 dhe se dialogu nuk do të ishte për status por vetëm për “përmirësimin e kushteve të jetës së përditshme të qytetarëve të thjeshtë në Kosovë”. Në të njëjtën kohë Beogradi vazhdonte insistimin se “ishte e pashmangshme të bisedohej për çështjen e statusit pasi që ndikon në të gjitha çështjet tjera”.

Nëse Prishtina nuk do të ishte në gjendje të përfitonte ndonjë koncesion nga Beogradi në çështjen e statusit, do të ishte e mundshme vetëm nëse BE-ja do të ofronte stimulime përmes “zgjerimit të tubës së karotave”. Karota e parë ishte çështja e shumëpritur e liberalizimit të vizave e cila ende nuk është realizuar. Kosova është një ndër vendet më të izoluar në botë⁴, ndërsa distanca me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor sa vjen e rritet pasi që shumë prej tyre kanë hyrë në listën e bardhë të Shengenit. Kosova nuk mundi të hynte në negociata për ri-pranim si dhe negociata për Stabilizim Asociim për shkak të pamundësisë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me BE duke marrë parasysh faktin që pesë shtete nuk e kanë njohur (Spanja, Sllovakia, Greqia, Qipro dhe Rumania). Pozicioni i BE-së kundrejt Kosovës kishte mungesë të ndikimit që pengoi përpjekjet e saj diplomatike dhe ndërmjetësuese.

Planifikimi i stimulimeve për Kosovën në Dialog ishte një nga detyrat kryesore për Robert Cooper, ndërmjetësuesin kryesor dhe një nga këshilltarët e Catherine Ashton për Ballkan dhe Lindje të Mesme. Ndikimi mbi Beogradin ishte më serioz pasi Beogradit i duhej statusi i kandidatit dhe një datë për fillimin e negociatave. Dilema nëse këto kërkesa ishin reale apo lëvizje taktike për tu pajtuar me më pak ishte pak e rëndësishme pas vizitës së Merkel me 22 gusht, 2011.

Mungesa e gatishmërisë për të anashkaluar dallimet e çështjeve që kanë të bëjnë me statusin la rrugë për më pak çështje politike si të vetmet mbi të cilat mund të bëhej ndonjë progres. Me dy palët sa më larg njëra tjetrës, temat e vështira do të zbraznin potencialin, prandaj u ofruan zgjidhjet më të lehta ‘paragjella’ për të demonstruar potencialin e dialogut që në fillim të tij.

Edhe pse Dialogu ishte paraparë të fillonte në fund to vitit 2010, ai ishte shtyrë për shkak të çështjeve të përmendura më lartë të krizës politike si dhe për shkak të zgjedhjeve në Kosovë. Raundi i parë zyrtarisht filloi në muajin mars të vitit 2011 dhe përfundoi në korrik me tri ‘marrëveshje’ (që u referuan si ‘konkludime’) mbi lirinë e lëvizjes, regjistrat civil dhe diplomat. Fjala ‘marrëveshje’ vihet në thonjëza për shkak të mënyrës se si ishin pajtuar (si përkushtim i njëanshëm) pasi që asgjë nuk u nënshkrua meqenëse Beogradi do ta konsideronte këtë akt si shenjë të njohjes⁵.

Ndërmjetësit qartazi konsideruan se opinioni publik nuk duhet të përfshihej shumë, së paku jo në fazën e parë që ishte më e ndjeshme. Kopjet e shkruara të marrëveshjeve rrallë u bënë publike. Ky nivel i kujdesit dukej i dyshimtë për nga ana e legjitimitetit, por ndoshta ishte e nevojshme që të lejohet një shkëmbim i besueshëm për të arritur në një lloj marrëveshje fillestare. Raundet e para të dialogut në thelb ishin prova për ndërtimin e besimit që në fund të fundit varet në nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tash.

Motivet për Dialog dhe pasojat politike

Integrimi Evropian është qartazi motivi kryesor për të cilin Beogradi ka hyrë në Dialog. Retorika e marrëveshjes me shqiptarët nuk tingëllon e sigurtë, por ajo përputhet me kushtet e BE-së. Është interesante të vërehet se Beogradi kishte këmbëngulur në dialogun teknik, kur Prishtina ishte e

⁴ESI. 22 nëntor 2010. Izolimi i konfirmuar. Si po i dëmton BE interesat e saj në Kosovë.

⁵ Komisioni Evropian përdor termin “marrëveshje” në Mendimin e vetë mbi Aplikimin e Serbisë si Anëtare Kandidat dhe Raportin e Progresit të Kosovës për 2011 por askush nuk është i sigurt nëse kjo i përmbush kriteret për definicionin ligjor të “marrëveshjes”. Pasi që këto janë më shumë “mirëkuptime reciproke” apo “marrëveshje verbale”, zbatimi i tyre do të varet në interpretimin e BE-së meqenëse nuk mund të ketë ndonjë interpretim ligjor objektiv.

frikësuar nga ndonjë dialog. Por pas fillimit të dialogut teknik, Beogradi synoi ta shtyjë atë më shumë drejt temave politike që Prishtina iu kishte shmangur fuqimisht.

Përderisa shumë analistë fajësuan Prishtinën që ka hyrë në një proces që pritej të ishte i paparashikueshëm, analistë të tjerë mbështetën atë për faktin se mospjesëmarrja e saj do të nënkuptonte që Serbia mund të marrë statusin e kandidatit pa bërë asnjë lëshim për Prishtinën. Dilema të reja dolën për Prishtinën pas refuzimit të vulave doganore (të njëjtat që ishin njohur nga Beogradi para vitit 2008) dhe përpjekjeve pasuese për të çimentuar kontrollin mbi veriun. Prishtina vërejti ambiciet politike që buronin nga ky proces i cili shtyri shumë ekspertë të argumentojnë se për aq kohë sa statusi ishte çështje e hapur për diskutim nga Beogradi, bisedimet teknike nuk kanë kuptim. Në një editorial për Vijesti, Agron Bajrami argumentoi se "për aq kohë sa Beogradi strehon ambicie të këqija në veri, nuk duhet të ketë dialog"⁶. Megjithatë, shumë anëtarë të BE-së janë të gatshëm të mbështesin kandidaturën e Beogradit dhe ambiciet e saj indirekte në veri të Kosovës. Duke biseduar në mënyrë indirekte me vende të ndryshme të BE-së, Beogradi vazhdimisht ka bërë oferta publike për Prishtinën për një zgjidhje të mundshme në veri.

Me pak fjalë, Serbia hyri në dialog për:

- a) Të fituar joshjen e BE-së;
- b) Pozitë më të mirë dhe përpjekje për të zhvendosur përqendrimin e dialogut nga teknik në atë politik;
- c) Si pasojë, të bëjë disa lëshime.

Kosova hyri në dialog për të:

- a) Fituar joshjen e BE-së;
- b) Marrë disa përfitime të vogla;
- c) Si pasojë, të rrezikojë fuqizimin e politikës së Serbisë në rrugë drejt BE-së.

Nëse me të vërtetë dialogu do të perceptohej si teknikisht i pastër, atëherë ai nuk do të kishte zgjuar nivelin e interesit që ai ka sot. Ekipi i Beogradit nuk e ka fshehur preferencën e tij për të kaluar në dialog politik dhe për të hapur çështjet që kanë të bëjnë me veriun. Edhe Plani Gjashtë Pikësh ishte kërkuar nga disa OJQ të serbëve të Kosovës të asocuara rreth rrjetit KPAN⁷. Një tjetër dëshmi se bisedimet teknike shihen si bisedime politike shfaqet nga një deklaratë e dhënë nga Xhavit Haliti, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, ku thotë se bisedimet nuk mund të jetë thjesht teknike me Serbinë⁸.

Dy politikat kontradiktore janë të papajtueshme në sy të parë pasi që Beogradi nuk do të njohë zyrtarisht Kosovën dhe Prishtina nuk do të bisedojë për integritetin e saj territorial. Por Beogradi ka arritur të pengojë anëtarësimin e Prishtinës në organizata ndërkombëtare dhe ka ruajtur praninë komunat në veri të Kosovës duke i mbështetur ato në mënyrë financiare, logjistike dhe me resurse njerëzore. Sistemi i shëndetësisë, arsimit, postës madje edhe sistemi bankar i Serbisë veprojnë në komunat serbe në veri, por edhe në pjesët tjera të Kosovës. Misionet ndërkombëtare në Kosovë që nga 1999 (UNMIK dhe EULEX) gjithashtu kanë lejuar që zgjedhjet serbe të organizohen në këtë pjesë të Kosovës. Prishtina ka hyrë në dialog në mënyrë që ose të rregullojë ndikimin e Serbisë në pajtim me Propozimin e Ahtisaarit, ose ti japë fund këtij ndikimi.

Prishtina ka hyrë në dialog në mënyrë që ose të rregullojë ndikimin e Serbisë në pajtim me Propozimin e Ahtisaarit, ose ti japë fund kësaj pranie.

⁶ Bajrami, Agron. 06.10.2011. Veriu qeveris. Vijesti, e qasshme në: <http://www.vijesti.me/kolumne/sjever-vlada-kolumna-41125>.

⁷ Rrjeti Strategjik i Veprimit të Kosovës (Kosovo Policy Action Network). 21 shtator 2011. Pse plani Gjashtë-pikësh nuk është duke u zbatuar? Deklarata e lëshuar nga KPAN, rrjet i OJQ-ve kosovare serbe.

⁸ RTK. 28 shtator 2011.

BE-ja ka hyrë në bisedime për të 'përmirësuar jetën e njerëzve dhe për të promovuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në BE. Si përfaqësuese e Lartë Ashton beson se:

Tani është koha e duhur për të filluar dhe ajo është e bindur se Beogradi dhe Prishtina bashkë mund të gjejnë mënyra praktike për të siguruar që jeta e rëndomtë mund të shkojë më mirë. Zgjidhja e problemeve përmes dialogut është mënyrë evropiane dhe objektivi i bisedimeve është që të promovojë bashkëpunimin dhe të sjellin bashkë Prishtinën dhe Beogradin më afër BE-së.⁹

Frika dhe perceptimet e Dialogut në Serbi dhe Kosovë

Metodologjia e zgjidhjes së konflikteve fillon duke trajtuar frikën dhe pastaj trajton interesat dhe pozicionet. Frika kryesore që të dyja palët ndajnë është të shmangen incidentet në pjesën veriore të Kosovës të cilat mbeten ende të mundshme. Serbia është e shqetësuar se incidentet në veri mund të shpiejnë në një valë të re të refugjatëve, megjithëse kjo mund të ti shërbejë Serbisë për ta portretizuar Prishtinën si agresive. Kosova është shqetësuar nga tensioni me qëllim të shmangies së radikalizmit të mëtejshëm që mund të vështirësojë integrimin e veriut në Kosovë.

Frika dhe brengat në Serbi

Frikat dhe brengat në Serbi janë se:

- ⇒ BE-ja do të detyrojë Serbinë që praktikisht të njohë Kosovën;¹⁰
- ⇒ Serbia do të humb përkrahjen e vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën (siç është cituar në një deklaratë Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë: "ne nuk mund të bëhemi serbë më të mëdhenj se vetë serbët");
- ⇒ Konsensusi i BE-së për Serbinë mund të humb përkrahjen që do të shpiente tek radikalizmi politik;
- ⇒ Humbja e besimit nga serbët e Kosovës dhe përshtypja se interesat e tyre janë braktisur, që mund të shpie tek humbja e demokratëve në zgjedhjet në Serbi;
- ⇒ Statusi i vendeve më të rëndësishme fetare.

Diskursi publik i portretizuar nga Borislav Stefanović, krye-negociatori i Serbisë shpesh thirret në modelin 'humanitar' me të cilin Dialogu shërben interesin e njerëzve të zakonshëm, dhe pastaj e kombinon atë me interesat e Serbisë për integrimet evropiane dhe në fund përdor argumentin që Dialogu do të bëhet një mjet për ndryshime në çështjet e statusit¹¹. Të gjitha këto arsye mund të dalin të vërteta, por gjithashtu ilustrojnë sa e ndërlikuar është situata në skenën politike të Serbisë dhe peshën që ka Kosova në këtë skenë.

Frika dhe brengat në Kosovë:

Frika e Kosovës për Dialog ishte e shumëanshme. Disa u frikësuan se Kosova nuk ishte e gatshme dhe se Serbia ishte shumë më mirë e përgatitur, por kjo diagnozë u nda edhe nga shumë tjerë që e përkrahnin dialogun. Kritikët shprehnin frikën që BE-ja në masë të madhe kishte vendosur të përkrahte kandidaturën e Serbisë dhe se bojkotimi i Prishtinës vetëm se do të mundësonte këtë kandidaturë pa asnjë koncesion ndaj Kosovës. Kërkesa për normalizimin e marrëdhënieve të Serbisë me Kosovën ishte e vakët dhe kjo mund të vërehet sidomos kur BE-ja ballafaqohet me frikën e humbjes së demokratëve në Serbi. Frika në Kosovë ishte nga:

⁹ Delegacioni i BE-së në Serbi, 8 Mars 2011, <http://www.europa.rs/en/mediji/najnovije-vesti/872/Statement+by+the+spokesperson+of+Catherine+Ashton,+EU+High+Representative+on+the+start+of+the+Belgrade++Pristina+dialogue.html>

¹⁰ Danas. 2 shtator 2011. Daçiq: Slligane hipokrite për Kosovën. Autor: P.D. http://www.danas.rs/danasrs/politika/dacic_licemerne_parole_o_kosovu.56.html?news_id=222821.

¹¹ Tanjug. 8 mars 2011, <http://www.tanjug.rs/videodet.aspx?galID=41047&videoID=118541>.

- ⇒ Pamundësia për të zbatuar reciprocitetin me dëme serioze në ekonomi;
- ⇒ Stërzgjatja e dialogut që vështirëson njohjen nga ato shtete që po presin rezultatet për të marrë një vendim;
- ⇒ Vazhdimi i izolimit dhe pamundësia për të marrë pjesë në forume ndërkombëtare, fitojë liberalizimin e vizave, inkasojë për transportin e energjisë dhe për përdorimin e hapësirës ajrore etj.;
- ⇒ Që Serbia të përparojë në rrugë drejt BE-së përpara Kosovës, dhe mëpastaj të bllokojë integrimin e saj, apo të lirohet nga kushtëzimi që do të shpiente në situatë asimetrike ngjashëm si në Qipro;
- ⇒ Frika e rrëshqitjes së dialogut për veriun e Kosovës, pastaj të hapet sovraniteti i Kosovës që do të mund të shpiente tek pazaret që mund të rezultojnë me një shtet jofunksional;
- ⇒ Ndalja e bisedimeve teknike për arsye politike do të thotë që Serbia ende kërcënon të sabotojë Kosovën.

Frika e Kosovës mund të shpjegohet me shkallën që statusi teknik aktual ndikon në zhvillimet në veri dhe me shkallën që ai bllokton njohjet dhe zhvillimin ekonomik.

Bregat e serbëve të Kosovës

Serbët e Kosovës, në veri dhe në jug, janë më të prekurit dhe më së paku të konsultuar në këtë proces. Bregat kryesore që janë:

- ⇒ Siguria e serbëve që jetojnë në Kosovën qendrore dhe në enklava;
- ⇒ Vakuumi institucional dhe sundimi i ligjit në veriun e Kosovës;
- ⇒ Serbët e punësuar në strukturat paralele frikësohen se mund të humbin punën apo t'u ulen pagat;
- ⇒ Atmosfera në Kuvendin e Kosovës përkeqësohet gradualisht;
- ⇒ Frika që dominon në veri mbi potencialin e hakmarrjes nga shqiptarët e Kosovës nëse Kosova e qeveris këtë pjesë;
- ⇒ Nëse arrihet një marrëveshje për veriun jashtë pakos së Ahtisaarit do të krijonte një frikë në mesin e serbëve në jug që disa nga kompetencat e fituara nga Ahtisaari do tu merreshin.

Është me rëndësi të jashtëzakonshme që dialogu së pari të adresojë bregat, ose së paku mos t'i përkeqësojë ato, gjatë kohës sa trajton çështjet tjera. Është e lehtë të konkludohet se disa nga bregat e lartpërmendura nuk kanë bazë të mjaftueshme në realitet, por edhe perceptimet janë problem në vete. Për shembull, frika se shqiptarët e Kosovës do të reagonin në veri po që se kjo pjesë do të kontrollohej nga Prishtina nuk ka bazë reale dhe qartazi është krijuar nga mungesa e kontakteve të të dyja palëve. Të vërteta apo të perceptuara, bregat janë aty dhe një proces i mbyllur i Dialogut nuk kontribuon në lehtësimin e tyre.

Çështjet në diskutim

Kjo pjesë shqyrton çështjet që janë diskutuar deri në tetor 2011 dhe përshkruhen një nga një më poshtë. Kjo pjesë pasohet nga një analizë e marrëdhënies në mes të fitimeve dhe humbjeve të secilës palë për çdo çështje për diskutim dhe në përgjithësi. Çështjet diskutohen sipas radhitjes që janë hapur (dhe disa prej tyre tashmë të përmbyllura) në bisedimet teknike.

Raundi i parë i Dialogut nuk kishte zgjuar aq shumë vëmendje të publikut në Beograd siç mund të paramendohej, apo së paku aq sa kishte zgjuar vëmendje në kryeqytetin tjetër, në Prishtinë. Praktikisht, nuk ishte shumë risi pos faktit se Prishtina dhe Beogradi ulen rreth një tryeze pas një kohe të gjatë. Nuk kishte reagime negative edhe pas raundit të parë kur Dialogu përmbylli çështjet e lirisë së lëvizjes, regjistrave civil dhe diplomave. Pakënaqësia në Serbi filloi kur liderët e serbëve të veriut filluan të deklarojnë se Prishtina nuk po bën koncesione por vetëm Serbia dhe se Dialogu është kundër interesave të komunitetit serb në Kosovë. Ky ishte një moment shumë i rëndësishëm

pasi që dallimet në politika në mes të dy palëve nga aty filloi të që zgjerohet, kështu duke dobësuar mundësitë e Beogradit për të zbatuar marrëveshjet nga raundet e fundit të Dialogut.

Lëvizja e lirë

Udhëtimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i vështirë për serbët dhe praktikisht i pamundur për kosovarët që nuk kanë dokumente personale dhe të udhëtimit të lëshuara nga Serbia. Qytetarët e thjeshtë e kanë gjetur veten në mes të një lufte politike të cilën ata nuk kanë mundur ta ndryshojnë dhe që e kufizon jetën e tyre të përditshme në çdo aspekt të mundshëm. Serbia nuk i ka pranuar pasaportat e Kosovës, targat e veturave, përderisa Kosova ka filluar të mos njohë targat e veturave të lëshuara nga komunat paralele të Serbisë në Kosovë (KM, GL, PR, PZ, DJ, PE, and UR) sikurse edhe letërnjoftimet e lëshuara nga këto organe. Kosovarët nuk mund të udhëtojnë në apo përmes Serbisë që i bën udhëtimet e tyre të vështira dhe të kushtueshme. Serbët e Kosovës kanë probleme me targat e tyre paralele në Kosovë, dhe për shkak të arsyeve politike (si dhe për arsye të shpenzimeve të mëdha pasi që u duhet të marrin sigurim të dyfishtë, paguajnë taksë të dyfishta për rrugët, si dhe detyrime të tjera për të dy vendet) nuk i pranojnë targat e reja të Kosovës.

Pavarësisht faktit se për këtë çështje marrëveshja ishte arritur në pranverë, zbatimi i saj ka qenë akoma në pikëpyetje në fund të vjeshtës.

Krahas pasaportave të vjetra jo biometrike dolën në skenë edhe dy lloje të pasaportave serbe biometrike. Disa kosovarë po ashtu përdorin pasaporta serbe, por shumica i përdorin pasaportat e rinj të lëshuar nga Kosova. Deri kohëve të fundit, në qarkullim kanë qenë edhe pasaportat e lëshuar nga UNMIK-u. Prezenca kaotike e mbi katër llojeve të pasaportave korrespondon me shumëllojshmëri të katër llojeve të targave. Kosova ka filluar të lëshojë targa të reja RKS, por me mijëra targa të UNMIK-ut akoma janë në qarkullim në Kosovë. Pavarësisht kësaj laramanie të targave dhe pasaportave, kalimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i vështirë, kështu që mundësimi i një udhëtimi të lehtë është bërë një nga çështjet e para të diskutimit.

Kur Serbia ka fituar liberalizimin e vizave, BE-ja ka kërkuar të bëjë dallimin e pasaportave që lëshohen për banorët e Kosovës nga ata të Serbisë, ku serbët e Kosovës mbeten në regjim të vizave së bashku me kosovarët e tjerë. Mbi të gjitha, për shkak të pasaportave, targave dhe sigurimit, udhëtimi në ose përmes Serbisë bart me vete shpenzime të mëdha për udhëtuesit kosovarë duke kontribuar kështu në mos-zhvillimin e Kosovës. Pavarësisht faktit se për këtë çështje marrëveshja ishte arritur në pranverë, zbatimi i saj ka qenë akoma në pikëpyetje në fund të vjeshtës.

Letërnjoftimet dhe targat e makinave

Varësisht nga interpretimi, kaosi aktual u zëvendësua me më pak apo më shumë kaos por pritet të sjellë më tepër mundësi për lëvizje për kosovarët. Nëse ato fillojnë, marrëveshjet e reja do të lejojnë udhëtim më të shpeshtë, më të sigurt dhe më të lirë, si dhe do të rrisnin ndërveprimin njerëzor përgjatë ndarjes etnike. Serbia nuk i ka pranuar pasaportat e Kosovës por edhe me marrëveshje nuk i kërkon (dhe as që i pranon) ato për kosovarët që dëshirojnë të udhëtojnë në Serbi. Kjo marrëveshje që do të duhej të hynte në fuqi me 1 nëntor 2011 do të kërkojë një letërnjoftim nga autoritetet e Kosovës. Kjo ishte një zhblllokim dhe ka treguar se si një çështje që është konsideruar si çështje e sovranitetit mund të mos jetë e tillë nëse paktohet me kujdes. Progres mund të arrihet edhe pa prekur çështje serioze duke ripaketuar ato si çështje që nuk kanë të bëjnë me statusin. Ndoshta do të ishte e dobishme të kujtonim për një çast bojkotimin e serbëve për faturat elektrike pasi që një kohë 'kjo nënkuptonte njohjen e Kosovës' por pak njerëz e përmendin tani këtë çështje. Beogradi po ashtu ka pranuar patentë shoferët e Kosovës nën klauzolën që 'pranimi i tyre nuk nënkupton njohjen e Kosovës'.

Nëse zbatohen, marrëveshjet e reja do të lejojnë udhëtim më të shpeshtë, më të sigurt dhe më të lirë, si dhe do të rrisnin ndërveprimin njerëzor përtej ndarjes etnike.

Një marrëveshje më modeste ishte arritur në targa e veturave dhe sigurimin. Shoferët kosovarë mund të udhëtojnë me targa të vjetra të UNMIK-ut në Serbi ose për ata që mbajnë targa RKS, të marrin targa të përkohshme (që ka ekzistuar si mundësi edhe para marrëveshjes). Problemi është që privilegji për serbët u jep atyre një shtytje për të mbajtur targa e vjetra KS (që duket të jetë qëllimi i qartë i Beogradit), por ajo edhe mund t'i dallojë ata nga të tjerët. Përderisa nuk ka kërcënime të sigurisë për serbët e Kosovës, veçimi i tyre është shkelle e të drejtave të njeriut dhe është pikërisht ajo çfarë dëshiron të shmang dizajni i targave të makinave në vendet mikse (Bosnja, Kosova gjatë UNMIK-ut dhe pas). Ka një argument që serbët e Kosovës të mos marrin targa RKS, pasi që një gjë e tillë nënkupton marrjen e targave “PROBA” kur të shkojnë në Serbi, që i bënë ata të duken shqiptarë në Serbi. Me gjithë të metat e zgjidhjes më lartë, së paku targa paralele mund të hiqen nga përdorimi, përfshirë edhe veriun.

Përparësia kryesore do të ishte mungesa e makinave të pasiguruara në rrugët e Kosovës. Të gjitha makinat serbe do të duhet të sigurohen kur të hynë në Kosovë dhe anasjelltas, apo siguri do të ketë njohje reciproke (përmes vendit të tretë). Miliona euro të taksapaguesve kosovarë do të kurseheshin dhe siguria në rrugë do të përmirësohej.

Diplomat e Universitetit

Politika e Serbisë për mosnjohje të dokumenteve të Kosovës aplikohet edhe në lloje tjera të dokumenteve, përfshirë diplomat universitare. Kjo më së shumti prek popullatën shqiptare të Preshevës dhe Bujanocit. Ky rajon është i prekur shumë nga varfëria dhe papunësia dhe barriera tjera administrative kontribuojnë në migrim masiv. Për shkak të sektorit privat pothuajse të pazhvilluar, një nga pak mundësitë për punësim në Luginën e Preshevës është gjetja e një pune në sektorin publik që është e pamundshme të arrihet me një diplomë të fituar në Prishtinë, ku shumica e të rinjve nga kjo zonë studiojnë. Mosnjohja e diplomave është vetëm një nga arsytet pse komuniteti etnik shqiptar që përbën shumicën në këtë rajon, është i nën-përfaqësuar në drejtësi, polici dhe administratë shtetërore. Kosova i njeh diplomat e shumicës së serbëve të Kosovës, por nganjëherë refuzon diplomat e lëshuara nga Universiteti i ‘Prishtinës’ i dislokuar në Mitrovicë dhe që menaxhohet nga Ministria e Arsimit të Serbisë.

Diplomat kanë qenë një nga temat e hershme dhe një marrëveshje në parim ishte kumtuar në pranverë. Parimi është që Beogradi nuk do të njohë drejtpërdrejtë (nostrifikojë) diplomat kosovare por përmes një ndërmjetësuesi. Në fakt, kjo zgjidhje ishte gjetur nga një numër i studentëve që kanë transferuar kredencialet e tyre në mënyrë individuale përmes Shkupit apo Tetovës. Meqë të dy universitetet përdorin kreditë e transferueshme ECTS (Sistemi Europian i Transferimit të Kredive), studentët i kanë transferuar lëndët në Maqedoni, kanë marrë ndonjë lëndë shtesë për të përmbushur kriteret, dhe në fund kanë marrë diplomë valide në Maqedoni. Me disa shpenzime shtesë të mijërave eurove, atyre që kjo u është dashur më së shumti kanë gjetur zgjidhje.

Marrëveshja specifikon që ky ndërmjetësues duhet të jetë ose një organizatë ndërkombëtare apo ndonjë universitet nga një vend i tretë (sipas të gjitha gjasave nga Maqedonia apo Mali i Zi). Kjo vështirë që mund të quhet marrëveshje por mund t'u mundësojë studentëve të Luginës së Preshevës që të punësohen në vendin e tyre. Sidoqoftë, kjo mund të detyrojë studentët në Mitrovicë që të kërkojnë zgjidhje jashtë kësaj kornize, pasi që Prishtina vështirë që do të njohë universitetin paralel të Prishtinës. Për këtë çështje më në fund ishte arritur marrëveshje në fund të nëntorit, por ekipet implementuese duhet akoma të kalojnë nëpër detaje.

Regjistri civil

Me largimin e saj nga Kosova në vitin 1999, administrata serbe morri me vete librat e regjistrimit civil të shumicës së komunave të Kosovës, duke i vendosur ato në komuna ‘paralele’ në Serbi (p.sh. komuna e Pejës ka operuar në Kragujevc, ajo e Prishtinës në Nish, etj). Serbët e Kosovës të vendosur në Serbi

i kanë përdorur ato dokumente, sikurse edhe shqiptarët që u kanë nevojitur për nevoja të ndryshme, shpesh duke paguar shuma të mëdha parash për të arritur tek to.

Pamundësia për të lëshuar dokumente origjinale për disa vite ka krijuar hapësirë për manipulime të shumta. Ky vakuum ligjor është keqpërdorur nga shtetas të vendeve të ndryshme duke pretenduar që janë shqiptarë që u janë marrë dokumentet dhe shumë prej tyre kanë kërkuar azil në Evropë. Zyrtarisht janë rreth 14,000 refugjatë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së gjatë vitit 2010, por ky numër nuk është real dhe konsiderohet që sipas të gjitha gjasave përfshin edhe individët nga vende tjera.

Kosova është ballafaquar me sfidë të gjatë për kompletimin e regjistrit të saj civil. Për 12 vitet e fundit Kosova ka përdorur procedura të vështira për të lëshuar certifikata të lindjes (dhe dokumente tjera personale) duke kërkuar fatura të energjisë elektrike me datë para 1 janarit 1998, duke sjellë dy dëshmitarë apo procedura tjera shtesë.

Përderisa kjo situatë ka zgjatur për rreth 12 vite tani kompletimi i dokumentacionit është bërë prioritet i lartë për shkak të liberalizimit e vizave. Kosova duhet të ofrojë nivel të lartë të sigurisë me rastin e lëshimit të certifikatave të lindjes dhe dokumenteve tjera relevante. Regjistri civil i Kosovës nuk është adekuat që e bën të vështirë pajisjen me dokumenta personal të diasporës, serbëve të zhvendosur, dhe në të njëjtën kohë nuk e lejon Kosovën që të ketë një regjistër civil dhe listë të votuesve të përditësuar.

Edhe Serbia edhe Kosova i konsiderojnë dokumentet e regjistrit civil si simbole të statusit, edhe pse ato zakonisht asocohen me komuna dhe jo me identitete shtetërore. Fundi i raundit të parë të dialogut solli edhe një “gjethe fiku” – Serbia do të dorëzojë përmes EULEX-it vetëm kopje të verifikuara të librave të regjistrit civil. Simbolika është ndoshta aspekti më i rëndësishëm i agjendës, kështu që kjo vetëm sa e forcon edhe më tepër argumentin se të dy palët janë duke e përdorur dialogun më tepër për show sesa për përmbajtje.

Përderisa politikisht ka qenë e ndjeshme, kopjet e regjistrit civil janë në parim të nevojshme që Kosova të kompletojë regjistrin civil, gjë që do të zgjidhte një numër të problemeve praktike. Përderisa marrëveshja tentative me Serbinë nuk e adreson kërkesën e Prishtinës për kthim të dokumentave si simbol të statusit, kopjet adresojnë nevojat praktike për të kompletuar të dhënat. Prishtina me sukses ka argumentuar aspektin praktik të kësaj edhe pse ka qenë cak i akuzave nga opozita. Nëse zbatohet, edhe pse me kopje, një objektiv është arritur dhe Kosova posedon dokumentet e saj duke bërë kështu një hap në trajektoren e gjatë të saj evropiane.

Marrëveshja për regjistrin civil shënon përfundimin e raundit të parë të bisedimeve për të cilat në parim ishte arritur marrëveshja në fillim të korrikut. Zbatimi i saj akoma nuk ka filluar dhe dy do të jetë testi më i madh fillestar i vullnetit politik dhe i gatishmërisë së Serbisë dhe Kosovës për t’ju përmbajtur zotimeve të tyre. Për Serbinë është e domosdoshme të amendamentohet ligji për Mbrotjen e të Dhënave Personale në mënyrë që të eliminojë pengesat ligjore për të dorëzuar kopjet e regjistrave tek Kosova.

Doganat dhe kadastra

Marrëveshja mbi doganat ka qenë e para që është ndarë me median si tekst i plotë edhe pse me 20 ditë vonesë dhe pasi që marrëveshja ka hyrë në fuqi. Konkluzionet e publikuara përkufizojnë marrëveshjet për vulat e doganave, tregtinë e lirë dhe marrëveshjen e kthimit të regjistrave kadastral. Se është arritur marrëveshje e paqartë ilustron nga artikulli në vijim i cili tregon që mosmarrëveshja ka të bëjë në tërësi për pikat kufitare dhe jo për vulat doganore:

Zyrtarët e doganave të Kosovës dhe policia e Kosovës nuk do të kontrollojnë pikëkalimet administrative në veri të Kosovës nga 16 shtatori, ashtu siç kanë paralajmëruar më herët autoritetet në Prishtinë. Në vend të tyre, përfaqësues të EULEX do ta kryejnë atë detyrë, kanë konfirmuar burime diplomatike të Danas-it në Bruksel dhe Prishtinë. Sidoqoftë, burimet

tona tregojnë që kjo nuk nënkupton që zyrtarët e doganave dhe policia e misionit të BE-së 'përgjithmonë do të kontrollojnë kufirin, por vetëm deri sa Prishtina gradualisht të krijojë autoritetin e saj në veri të Kosovës, dhe ky proces mund të zgjasë me vite'¹².

Pasuan protestat e dhunshme dhe vendosja e barrikadave me një rol miks të Beogradit. Beogradi hapur i ka përkrahur barrikadat por është munduar që mos ta ndërlihd veten me elementet me të dhunshme. Pikëpamjet alternative argumentojnë që problemi në veri është i njëjtë si në krejt Serbinë, rreziku i forcave paralele të sigurisë.

Tregtia e lirë dhe vulat doganore

Ndoshta mosbalanci më i madh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë tregtia. Për një vit Serbia eksporton në Kosovë më tepër se 300 milionë euro, përderisa Kosova eksporton më pak se sa 5% të importeve të saj, të cilën në Serbi e bën përmes kontrabandës apo dokumenteve të lëshuara nga institucionet paralele. Një jobalancë e tillë tregtare do të shpiente në panik çdo shtet të zhvilluar dhe gradualisht kjo ka alarmuar edhe shumicën e kosovarëve. Duke kërkuar reciprocitet, durimi i Kosovës shkante duke u zbehur dhe përfundimisht një afat ishte paralajmëruar në fillim për qershor e krejt në fund për 20 korrik të vitit 2011.

Dialogu u përball me një pengesë të madhe pas raundit të parë kur u ngritën çështje të tregtisë së lirë dhe vulave doganore, të cilat u shtyn nga korriku në shtator. Edhe pse vulat e Kosovës nuk e përmbajnë fjalën 'republikë', udhëheqësi i delegacionit serb në bisedime ka thënë vazhdimisht që asnjë vulë me simbole të shteti të Kosovës nuk do të pranohet. Mosmarrëveshja që fillimisht dukej joracionale u sqarua kur Prishtina e kuptoi se në agjendë të Beogradit ishte ndarja. Raundi për vulat doganore në korrik ishte refuzuar për shkak të llogaritjes së gabuar të Beogradit se Prishtina nuk do të jetë në gjendje të zbatojë reciprocitetin në praktikë, së paku jo në kufijtë e saj verior. Beogradi ka pritur që Prishtina do të ishte e kënaqur me zbatimin e masave të reciprocitetit përgjatë lumit Ibër, duke logjikuar se i mjafton që të privojë Beogradin nga 95% e tregut kosovar.

Vendosja e zyrtarëve doganorë në Ibër natyrisht që do të përdorej nga Beogradi si lëvizje për të forcuar dhe legalizuar kontrollin e saj mbi veriun e Kosovës. Veprimi i Kosovës me 25 korrik 2011 ndryshoi kalkulimet. Së pari vetëm, e pastaj me përkrahje të hapur ndërkombëtare, Prishtina kërkoi të zbatojë të dyja, edhe reciprocitetin edhe vendosjen e kontrollit mbi veri. Tensionet shkuan lartë por në përgjithësi u mbajtën nën kontroll. Paralajmërimet se kryetarët e komunave të veriut dhe kriminelë të ndryshëm politik do të arrestohen ngritën akuza të brendshme ndërmjet Beogradit dhe liderëve të veriut. Pavarësisht rolit fillestar në ngritjen e barrikadave, Beogradi tani nuk e asocion veten me barrikadat, përderisa liderët e veriut bëjnë presion në Beograd që të deklarohen se në cilën anë janë.

Rekomandimi i Komisionit Evropian për të dhënë statusin e kandidatit për Serbinë,

“duke pasur parasysh progresin e arritur deri më tani dhe se Serbia do të riangazhohet në dialog me Kosovën dhe do të shkoj drejt zbatimit të plotë të marrëveshjeve të arritura deri më tani”.

Beogradi u tërheq nga Dialogu me 28 shtator duke thënë se është e vështirë që “të vazhdohet dialogu përderisa ka të shtëna” në Jarinjë (pika më veriore kufitare e Kosovës). Nëse Beogradi do të vazhdonte bisedimet ajo do të kërcënonte lidhjet e saj me serbët e Kosovës në veri. Se kjo “çarje në mur” nuk do të mund të riparohej u bë e qartë pasi që Komisioni Evropian publikoi Opinionin e tij mbi statusin e aplikimit për anëtarësim me 12 tetor. Opinioni në thelb ishte pozitiv por me disa kushte. Komisioni Evropian ka rekomanduar që Këshilli i Ministrave i jep statusin e kandidatit Serbisë

¹² Danas. 14 shtator 2011. Prishtina gradualisht do ta marrë kontrollin në veri.

“duke pasur parasysh progresin e arritur deri më tani dhe se Serbia do të ri-angazhohet në dialog me Kosovën dhe do të shkojë drejt zbatimit të plotë të marrëveshjeve të arritura deri më tani”¹³.

Një unitet i tillë i paprecedentë i BE-së për një kusht të tillë ka nënkuptuar që Beogradi i duhet të pranojë pikat kufitare 1 dhe 31 pa i futur ato në dialog dhe do të lejojë operimin e EULEX-it në tërë Kosovën. Vetëm temat në vijim ishin të pranueshme: njohja e diplomave, bashkëpunimi rajonal përfshirës, telekomunikacioni dhe energjia. Serbët e Kosovës reagueshan të parët dhe lëshuan një deklaratë të përbashkët me 19 tetor ku refuzuan për të zbatuar çfarëdo marrëveshje që ka arritur apo do të arrijë Beogradi në dialog me Prishtinën.

Opinionin e Komisionit Evropian ka qenë më pak pozitiv për Kosovën dhe udhërrëfyesi për liberalizim të vizave, për të cilin Kosova veçse i ka plotësuar kushtet (për udhërrëfyes, jo për liberalizimin), vështirë që mund të konsiderohet një karotë. Gjetja e një mënyre për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në do të ishte një përfitim më i madh krahasuar me ato të Beogradit. Sidoqoftë, e ardhmja e liberalizimit të vizave do të ishte një fitore e madhe për çdo qeveri në Prishtinë njëjtë sikur ka qenë edhe për vendet tjera të Ballkani Perëndimor të cilat tanimë janë në “Listën e Bardhë të Shengenit”.

Mosmarrëveshja kryesisht ishte për pranimin e vulave doganore që përdor Kosova, qartazi çështja më shqetësuese që është diskutuar gjer më tani. Para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ishte arritur marrëveshja që për të pasur tranzicion të lehtë në CEFTA, Kosova nuk do të ndryshojë vulat e saj dhe ato kanë mbajtur tekstin e njëjtë “Doganat e Kosovës” pa ndonjë referencë eksplicite në shtetësinë e saj.

Krejt kjo situatë konfrontuese krijoi një zonë gri në tregtinë ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Edhe pse Serbia nuk e njeht Kosovën dhe eksporton për çdo vit 300 milionë euro, ajo e përdor termin ‘dërgesë/pranim’ si ekuivalente të eksportit/importit. Për më tepër, pikat doganore janë menaxhuar nga Policia e Kosovës e përbërë nga serbë lokal nga komunat e veriut të Kosovës në mënyrë që institucionet e Kosovës të bëhen më të pranueshme për serbët lokal.

Mosmarrëveshja u përqendrua në tekstin e vulës ku Beogradi refuzoi çdo ‘atribut të shtetësisë’, e cila më vonë doli të ishte ‘mungesa e fjalës Republikë’ (e cila sidoqoftë asnjëherë nuk ka qenë në vulë). Përmes kësaj, qeveria e Serbisë insistonte në implementimin e të ashtuquajturit “Plan Gjashtë Pikësh”¹⁴ të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së i cili është i papranueshëm në Kosovë.

Nga grindja tregtare në barrikada

Duke ju frikësuar ndarjes faktike, Prishtina bëri një përpjekje të rrezikshme për të vendosur zyrtarët e doganave dhe policinë në dy pikëkalimet veriore dhe ja doli që të ndalojë strategjinë e Serbisë për ndarje. Pa përkrahjen logjistike dhe duke u përballur me rrugë të bllokuara, i detyroi forcat policore që të tërhiqen dhe tensionet vazhduan për disa muaj:

¹³ Komisioni Evropian. 12 tetor 2011. "Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin" Bruksel, 12.10.2011, COM(2011) 668 final, SEC(2011) 1208 final, f. 12, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/sr_rapport_2011_en.pdf.

¹⁴ Foniqi-Kabashi, Blerta. 27 nëntor 2008. Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoj Planin Gjashtë Pikësh të Banit. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/11/27/feature-02.

Ky ishte një demonstrim i vogël i sovranitetit, i cili ishte kundër dëshirës, por i pranuar me vendosmëri nga ndërkombëtarët në Kosovë. Për më tepër, pavarësisht veprimit të Kosovës, dy palët më në fund kanë arritur marrëveshjen e pranimit të vulave doganore nga zyrtarët e Doganave të Serbisë, çfarë lehtëson edhe tregtinë midis dy vendeve¹⁵.

Me ngrirjen e përkohshme të çështjes së sovranitetit, u hap debati për tregti. Prodhuesit vendorë të Kosovës ishin të kënaqur. Çmimet nuk u rriten ashtu siç ishte parashikuar dhe bilanci tregtar për gusht ishte më i miri në histori të Kosovës. Çmimet e ulëta të Serbisë për eksport kanë përfituar nga mungesa e taksave pasi që ato futeshin përmes veriut. Për më tepër, në Kosovë u rrit dyshimi se Serbia ka një politikë dampingu të motivuar politikisht.

Dialogu vazhdoi me 3 shtator dhe të dy palët arritën marrëveshje për vulat doganore (ku do të shkruhej “Doganat e Kosovës”). Të dy palët pretenduan fitore por pas gjithë kësaj ka një ndjenjë se BE nuk e ka mbajtur situatën ashtu siç duhej nga korriku deri në shtator. Pauza u mundësoi të dy palëve që të reflektojnë. Beogradi ka pritur ta përdorë pamundësinë e Prishtinës për të forcuar kontrollin e saj në veri gjë që do t'i mundësonte asaj për ta sjellë veriun në raundet e reja të dialogut. Dërgimi i njëanshëm i forcave policore të Prishtinës do të mund të ndryshonte situatën në terren dhe do të përmirësonte pozicionin e saj negociues. Kjo situatë ka mbetur e tensionuar deri në mes të shtatorit kur KFOR u përpoq që të kthejë sërish situatën nën kontrollin civil. Një kombinim i zyrtarëve të KFOR-it, EULEX-it dhe autoriteteve të

Konkluzionet për njohjen e vulave doganore janë specifikuar në tri pika, dhe çdo gjë përmban marrëveshja është:

1. Palët do të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave në përputhje me marrëveshjen e CEFTA-s;
2. Vulat doganore me mbishkrimin ‘Dogana e Kosovës’, siç u është konfirmuar të gjitha palëve të CEFTA-s, do të pranohen;
3. Të gjitha dokumentet dhe komunikimet përcjellëse gjithashtu do ta pasqyrojnë këtë formulim.

Konkluzionet për të cilat është arritur marrëveshje me 2 shtator për dokumentet kadastrale

1. Me qëllim për t'i mbrojtur të drejtat e njerëzve me kërkesa legjitime në pronë, palët do të bëjnë çdo përpjekje për ta vendosur një kadastër plotësisht të besueshëm në Kosovë;
2. Një grup trepalësh, i përbërë nga ekspertë kadastralë nga të dyja palët dhe i kryesuar nga BE-ja, do ta monitorojë punën e një agjencie teknike (të përzgjedhur pas konsultimeve me të dyja palët), roli i së cilës do të jetë që t'i identifikojë zbrazëtitrat në shënimet kadastrale origjinale të para vitit 1999
3. Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE) thuhet se do t'i marrë kopjet e të gjitha shënimeve origjinale kadastrale, të cilat janë larguar nga Kosova, ndërkaq, sipas kërkesës, PSBE do të ofrojë të dhëna të caktuara nga Kosova;
4. Agjencia teknike, e lartcekur në pikën 2, do t'i krahasojë të gjitha kopjet e shënimeve kadastrale origjinale të pronës private të para vitit 1999 me kadastrën e rikonstruktuar të Kosovës. Rastet kur krahasimi tregon se shënimet nuk përputhen do t'i përcillen nga grupi trepalësh një mekanizmi gjyqësor në Kosovë. Ky mekanizëm gjyqësor do të përcaktojë përfundimisht se cilat shënime kadastrale janë të sakta;
5. Shkalla e parë e mekanizmit gjyqësor do të ushtrohet nga një komision i ekspertëve kadastralë dhe pronësorë ndërkombëtarë dhe kosovarë. Shumica e ekspertëve do të emërohen nga PSBE-ja, duke marrë parasysh interesat e të gjitha komuniteteve;
6. Gjykata Supreme e Kosovës do të veprojë si shkallë e dytë e apelit e mekanizmit gjyqësor. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës do të merren nga një kolegji në të cilin shumicën do ta mbajnë gjykatësit ndërkombëtarë dhe do të jenë vendime përfundimtare dhe pa mundësi ankese;
7. Vendimet të cilat dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartcekur do t'u kumtohen të gjitha palëve të interesuara. Agjencia Kadastrale e Kosovës do t'i zbatojë vendimet përfundimtare që dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartcekur, duke i futur ndryshimet e nevojshme në kadastrën e Kosovës.
8. Grupi trepalësh implementues do ta monitorojë zbatimin dhe funksionimin e shpejtë të aranzhmaneve të lartcekura dhe do ta njoftojë rregullisht Dialogun lidhur me progresin

¹⁵ Abramowitz, Morton dhe James Hooper. 20 shtator 2011. Ultimatumit evropian ndaj Serbisë. Publikuar në *The National Interest*.

Kosovës u transportuan në veri.

Çështja e veriut dhe Plani Gjashtë Pikësh u tentuan që të futen edhe një herë në agjendën e bisedimeve. Udhëheqësi i delegacionit serb në dialogun Beograd-Prishtinë, Borislav Stefanović, ka thënë se bisedimet e 2 shtatorit në Bruksel kishin të bëjnë vetëm me vulat doganore dhe me dokumentet përcjellëse përderisa pikëkalimet administrative nuk janë diskutuar. Ai tha që pikëkalimet veriore nuk ishin diskutuar dhe e paralajmëroi Prishtinën mos të konsiderojë rinisje të aksioneve të njëanshme. Hashim Thaçi e pranoi sugjerimin e fuqive perëndimore për të mos përgatitur aksione shtesë por pasoi një përfshirje multilaterale e KFOR-it dhe EULEX-it.

Ngjarje të reja ndodhën me 16 shtator kur EULEX dhe KFOR ndihmuan Doganat e Kosovës për t'u pozicionuar në dy pikëkalimet e kontestuara, Jarinjë dhe Bërnjak. Serbët e Kosovës reagueshan duke bllokuar rrugët në veri të Kosovës dhe mosmarrëveshjet vazhduan duke u pasuar me deklarata kontradiktore nga të gjitha anët. Zyrtarët e Beogradit pretenduan që Marrëveshja mbi Vulat Doganore e 2 shtatorit nuk ka specifikuar asgjë për pikat doganore dhe një gjë e tillë duhet diskutuar. Në anën tjetër ambasadori i BE-së në Serbi dhe zëdhënësi i zonjës Ashton e konsideruan marrjen e pikave doganore në përputhje me marrëveshjen e apostrofuar më lart¹⁶. Ky është një shembull i qartë ku jotransparenca e dialogut kishte një çmim të lartë duke mos sjellë përfitimet e dykuptimisë kreative. Teksti i marrëveshjeve është konfidencial edhe pse zbatimi i tyre prek secilin qytetar.

Është e vështirë të kuptohet arsyeshmëria e refuzimit të Beogradit për të pranuar zyrtarët e doganave të Kosovës duke pasur parasysh pranimin e vulave të "Doganave të Kosovës". Për më tepër këto vula ishin njohur nga UNMIK-u që ishin në pajtim me Rezolutën 1244 dhe njëjtë sikur UNMIK-u edhe EULEX-i vazhdon ta trajtojë Kosovën si zonë të veçantë doganore. Beogradi po ashtu ka njohur Kosovën si një zonë të tillë por me shpalljen e pavarësisë nuk e njeh më. I vetmi shpjegim është përpjekja për ta trajtuar veriun si diç të ndryshme në mënyrë që të krijohet precedent.

Vazhdueshmëria e barrikadave ka përkeqësuar situatën në mënyrë të skajshme. Z. Stefanović ka thënë që çdo përpjekje e dhunshme për të larguar barrikadat në veri të Kosovës do të ishte e keqe për sigurinë dhe do të mund të keqësonte situatën edhe ashtu jo-stabile, gjë që nga disa mund të konsiderohet edhe si kërcënim. Presidenti i Serbisë Tadiq ka përsëritur:

Ne jemi duke e paralajmëruar në vazhdimësi bashkësinë ndërkombëtare që një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë, për rreziqet që mund të dalin nga lëvizjet unilaterale dhe të dhunshme të Prishtinës. Nëse dikush e ka menduar një gjë të tillë, nëse dikush rrezikon luftën në këtë pjesë të Evropës, ai duhet të marrë përgjegjësinë për të gjitha pasojat. Serbia nuk dëshiron luftë. Serbia nuk dëshiron asnjë lloj dhune dhe paqja është politika jonë dhe ka për qëllim krijimin e një paqe të qëndrueshme në Ballkan. Nëse Prishtina ndërmer aksione të tilla ajo do të mbajë përgjegjësinë për të gjitha pasojat¹⁷.

Pavarësisht paralajmërimeve kundër Prishtinës, progresi në veri ka gjasa të vazhdojë me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare. Serbia do të vazhdojë të përkrah drejtpërdrejt veriun por jashtë do të paraqesë një qëndrim miqësor dhe kjo do të rrisë mundësitë për lobim për një status të avancuar të veriut të Kosovës si dhe të bëjë progres në rrugëtimin e saj evropian si kompensim për humbjen e veriut. Në një fjalim të tij presidenti i Serbisë, Boris Tadiq, pas takimit me Merkel tha:

¹⁶ BETA. 16 shtator 2011. BE: Kosova një zonë donagore [EU: Kosovo jedna carinska oblast.] <http://www.beta.rs/?tip=article&kategoria=vestidana&ida=2571678&id=&ime=>

¹⁷ Bujosheviq, Dragan. 28 gusht 2011. Biseda e javës: Boris Tadiq, President i Serbisë (pjesa e dytë: E pranoj rrezikun e vonimit të fitimit të statusit të kandidatit) [Razgovor nedelje: Boris Tadić, predsednik Srbije (2. Deo: Prihvatom rizik odlaganja dobijanje statusa kandidata)]. <http://www.politika.rs/rubrike/Politika/Prihvatom-rizik-odlaganja-dobijanje-statusa-kandidata.lt.html>.

Më duhet të ju them se diskutimi me kancelaren gjermane nuk ka qenë se si t'i mbylлим dyert por si ti hapim ato. Ne erdhëm në përfundim se duhet të përpiqemi edhe një herë për të kërkuar zgjidhje kreative dhe të qëndrueshme e cila do të kënaqte të dy palët¹⁸.

Niveli i mirëkuptimit të tyre është dukshëm i ekzagjeruar pasi që konferenca për shtyp më tepër shfaqti mospajtime sesa marrëveshje. Se Serbia do të luajë sipas rregullave të BE-së, Tadiq e konfirmoi duke thënë:

Serbia kështu i përmbush kushtet evropiane: është pikëpamja jonë që ne duhet të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme për dialogun, një zgjidhje që është e pranueshme për të gjithë, të gjejmë një zgjidhje që nuk do të përzë serbët nga zonat ku ata kanë jetuar me shekuj, që nuk do të fshijë ndonjë kulturë nga ndonjë pjesë e kontinentit, që nuk do të prodhojë rreziqe të reja të sigurisë, që do të krijojë një paqe të qëndrueshme, dhe prandaj është fitimprurëse për krejt Evropën.¹⁹

Dialogu ka potencial të shkrijë situatën në veri, por periudha e deritashme e vështirë mund të ketë ngrirë atë edhe më tepër në ndërkohë.

Analizë e fitimeve dhe humbjeve që nga marrëveshja e parë

Potenciali për dialog të mëtutjeshëm duhet të ekzaminohet duke shqyrtuar rezultatet e marrëveshjeve të para. Mundësia e raundeve pasuese të bisedimeve është në varësi të efekteve të marrëveshjeve të para dhe të përkrahjes publike që këto gëzojnë. Se implementimi është vështirësuar nga 'detajet' është indikative që për mungesën e vullnetit politik, konsensusit dhe kapaciteteve të dobëta për implementim. Prandaj, analiza e fitimeve dhe humbjeve mund të bëhet vetëm duke marrë në konsideratë marrëveshjet e arritura, përgatitja dhe deklaratat për atë çfarë na pret. Sidoqoftë edhe në fund të nëntorit nuk ishin publikuar të gjitha detajet.

Pa marrë parasysh rezultatet reale, pritjet nuk janë menaxhuar si duhet dhe pjesë të pakënaqësive duhet kërkuar atje.

Reagimet po ashtu mund të jenë të motivuara politikisht, kështu që një ekzaminim i fitimeve dhe humbjeve reale është i rëndësishëm. Krahas diskutimit të reagimeve, ky punim analizon shkëmbimin e fitimeve dhe humbjeve duke mos neglizhuar faktin që mund të ketë ndërlikime të shumta që mund të vështirësojnë zbatimin.

Analiza e fitimeve dhe humbjeve nuk është e mundshme pa shqyrtuar edhe pritjet. Kosovarët u shtynë të besojnë që Serbia praktikisht do të pranojë ekzistimin e Kosovës si shtet. Në Serbi u ngritën pritjet se ky dialog do të shpie në 'kompromisin historik' për statusin. Tash së fundi pritjet janë reviduar ku kosovarët shohin më pak përfitime dhe një frikë në rritje se pragu i kushteve për Serbinë do të ulet dhe të sjellë shumë më pak se sa normalizimi që kërkohej nga Serbia në shkëmbim të dhënies së kandidaturës. Serbët e Kosovës kanë pritur zgjidhje të thjeshta për problemet e tyre ditore dhe presin përmirësim në jetën e tyre. Pa marrë parasysh rezultatet reale, pritjet nuk janë menaxhuar si duhet dhe pjesë të pakënaqësive duhet kërkuar atje.

Reagimet në Kosovë

Shumica e reagimeve në Kosovë nuk kishin të bëjnë me substancën e raundeve të para por për formën dhe vazhdimin e mundshëm. Ish-ministri i punëve të jashtme të Kosovës, Skënder Hyseni, ka kritikuar faktin që këto nuk janë marrëveshje por janë konkluzione. Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë se Qeveria e ka anashkaluar Kuvendin gjatë procesit të dialogut. Klubi për Politikë të Jashtme ka thënë se Kuvendi i Kosovës duhet të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme ku Qeveria do të duhej të raportojë për marrëveshjet e arritura në

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

Bruksel. Pak kanë shprehur nivel të kënaqësisë me mundësinë e ofruar për të udhëtuar në Serbi, kryesisht për shkak të zgjidhjes gjysmake të arritur.

Deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë thanë që dialogu ka dështuar që në fillim. “Serbia ka pasur objektiva të qarta dhe i ka arritur ato”, ka thënë Skender Hyseni nga LDK. “Kosova nuk ka fituar asgjë nga dialogu,” ka thënë Burim Ramadani nga AAK që ka bërë thirrje që dialogu të ndalej pasi që deri më tani nuk ka pasur asnjë përfitim nga ai. Deputetët e opozitës janë të bindur që nëse dialogu vazhdon me të njëjtin sistem, Kosova do të jetë e vetëkënaqur me dialogun për liberalizim të vizave përderisa Serbia shumë shpejt do t’i bashkëngjitet BE-së.

Deputetët e opozitës janë të bindur që nëse dialogu vazhdon me të njëjtin sistem, Kosova do të jetë e vetëkënaqur me dialogun për liberalizim të vizave përderisa Serbia shumë shpejt do t’i bashkëngjitet BE-së.

Nëse do të ketë implementim të suksesshëm të marrëveshjeve të arritura deri më tani, dhe duke pasur parasysh një çështjesh tjera që do të adresohen dhe trajtohen, Kosova do të humb diçka dhe do të fitojë diçka tjetër.

Cfarë humb Kosova?

Një humbje e qartë ka qenë ngadalësimi i njohjeve. Një numër i shteteve kanë deklaruar se nuk do ta njohin Kosovën përderisa dialogu ka akoma rezultate për të prodhuar. Natyrshëm, disa shtete mund të vendosin që mos ta njohin kurrë Kosovën nëse ajo largohet nga dialogu, përderisa disa shtete tjera ndoshta do ta njohnin Kosovën pa prituri pafundësisht. Kjo humbje nuk është e lidhur me dialogun si të tillë, për me tejzgjatjen e procesit. Për ata që me Serbinë shohin një lojë me shumë zero, Kosova do të marrë më pak si shpërblim nga Bashkimi Evropian në procesin e saj të integritetit, dhe Serbia që është duke përmirësuar situatën e saj shpejtë do të krijojë pabarazi më të madhe në pozicionet negociuese.

Cfarë fiton Kosova?

Në anën tjetër, Kosova merr disa përfitime. Pak kosovarë udhëtojnë për në Serbi, por me mijëra do të udhëtonin tranzit për në Evropën Perëndimore. Secili që ka shkuar në mes të verës në Kroaci mund ta dëshmojë që shumica e veturave me targa gjermane që kalojnë nëpër Dubrovnik nuk janë turistë që vizitojnë Malin e Zi, por punëtorë kosovar që vijnë në shtëpitë e tyre përmes një rruge dytësore duke mos mundur të udhëtojnë nëpër Rumani, Serbi apo Bosnjë.

Shumica e veturave me targa gjermane që kalojnë nëpër Dubrovnik nuk janë turistë që vizitojnë Malin e Zi, por punëtorë kosovarë që vijnë në shtëpitë e tyre përmes një rruge dytësore duke mos mundur të udhëtojnë nëpër Rumani, Serbi apo Bosnjë.

Nga mundësia për të udhëtuar në Serbi do të përfitonin me mijëra kosovarë shumica e të cilëve do të udhëtonin tranzit për në vende të treta dhe që do t’u kushtonte dukshëm më lirë sesa biletat e shtrenjta të aeroplanit që aktualisht i paguajnë. Fatkeqësisht, udhëtim i tillë i lirë vetëm pjesërisht u shkon për shtati atyre që mendojnë të marrin veturat e tyre në Serbi apo vende tjera. Udhëtimi me targa RKS në Serbi do të kërkojë edhe marrjen e targave të përkohshme që do të jenë të kushtueshme dhe lehtëzi mund t’i bëjë

kosovarët cak të sulmeve të ndryshme. Marrja e targave KS do të jetë shumë e vështirë për shqiptarët e Kosovës kështu që shumë pak do të përfitonin nga ky opsion.

Zhdukja e targave të lëshuara nga administratat komunale paralele në Serbi nuk është një arritje e vogël. Standardizimi i targave do të krijojë faktorin unifikues më të madh në veri që nga shpërthimi i armiqësive në vitin 1999. Nëse realizohet, marrja e targave KS në veriun e Kosovës me bekimin e Beogradit është një përmirësim i qartë, një progres i shënuar nga targat KM apo mungesa e tërësishme e targave. Prishtina po ashtu do të fitonte të hyra në buxhet nga sigurimi i mijërave veturave sikurse edhe do të kursente miliona euro që sot paguhen për dëmet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara. Marrëveshja nuk jep reciprocitet të plotë me Serbinë (automjetet e së cilës do të vijnë në Kosovë pa paguar sigurim shtesë) por është një marrëdhënie më e mirë se sa sot.

Marrëveshja nuk jep reciprocitet të plotë me Serbinë por është një marrëdhënie më e barabartë se sa sot.

Edhe pse kompromisi me kopje që ka qenë i vështirë, Kosova do të jetë e gatshme të kompletojë regjistrin e saj civil, që do të ketë efekte pozitive në proceset e tjera siç janë kriteri i liberalizimit të vizave, listat e votuesve, etj. Ekonomia e Kosovës po ashtu do kishte një rritje të vogël pasi që më shumë para do të shpenzoheshin nga ato që kursehen nga biletat e udhëtimit, taksat e sigurimit do të sjellin po ashtu miliona euro më shumë.

Reciprociteti do të rrisë shpenzimet e importeve të Serbisë duke hequr trajtimin preferencial, do të përmirësojë buxhetin dhe fuqizojë sadopak prodhuesit lokal. Produktet e Kosovës do t'a kenë më të lehtë për të eksportuar përmes Serbisë (ndoshta jo në vetë Serbinë), gjë që do të mundësojë ngritjen e kompanive të mëdha eskportuese.

Reagimet në Serbi

Reagimet e zyrtarëve dhe opozitës në Beograd ishin kryesisht pozitive sa i përket marrëveshjeve të arritura me 2 korrik. Nuk është e çuditshme që të gjitha deklaratat e partive në koalicion kanë qenë afirmative, por po ashtu edhe partia kryesore opozitare Partia Progresiste Serbe (SNS) ka qenë përkrahëse e hapit të parë dhe ka thënë që bisedimet duhet të vazhdojnë pasi që “ato janë në interes të qytetarëve”²⁰. Pasi që SNS është partia opozitare më e madhe, kjo ka qenë një shenjë e shfaqjes së një konsensusi politik në favor të politikës kundrejt Kosovës. Konsensus të mëhershëm më të gjerë ka pasur vetëm për integrimin evropian, i cili ishte arritur në vitin 2008 pas ndarjes së SRS (Partisë Radikale Serbe).

Vetëm dy parti kanë ngritur pakënaqësitë e tyre me faktin e arritjes së çfarëdo marrëveshje me Prishtinën – ata kanë qenë DSS e Koshtunicës dhe SRS e Sheshelit. Ata e kanë quajtur marrëveshjen si “njohje e ngadalshme” e pavarësisë së Kosovës. Nga disa mundësi të rralla për të parë përfaqësuesit e serbëve të Kosovës nga veriu dhe nga jugu që shkëmbejnë pikëpamjet e tyre me Beogradin²¹, ishte e qartë që interesat ndërmjet veriut dhe jugut dallojnë, ku pikëpamjet nga veriu shpreheshin që nuk ka përfitim nga dialogu. Në fakt, ky ka qenë edhe dallimi i parë serioz në mes të serbëve të Kosovës nga veriu dhe zyrtarëve në Beograd.

Çfarë humb Beogradi?

Disa nga kompromiset janë të vështira për t'u kundërshtuar, kështu që një pjesë e rëndësishme mund të thonë që Serbia e ka shitur Kosovën për BE-në. Edhe pse ka mungesë të popullaritetit publik, Serbia është në gjendje që ta paraqesë kompromisin si të arsyeshëm pa e cënuar interesin e saj kombëtar.

Çfarë fiton Beogradi?

I vetmi motiv për Beogradin është statusi i kandidimit dhe hapja e negociatave me BE. Dikush mund të thotë që është në interes të Serbisë që të zgjidhë problemet e përditshme me Kosovës, sikurse edhe të përmirësohen marrëdhëniet me fqinjin jugor pavarësisht mosmarrëveshje territoriale. Sidoqoftë, Beogradi ka qenë më i kënaqur me situatën në terren sesa Prishtina para fillimit të Dialogut. Motivimi shtesë për Beogradin mund të jetë mendimi se mund t'a forcojë marginalizimin e Kosovës nga rrjedhat ndërkombëtare duke mos kaluar ‘vijën e saj të kuqe’. Përderisa shumë serbë mendojnë se kushtet për Kosovën janë rritur me kalimin e kohës, shumë kosovarë mendojnë se kriteret për Serbinë janë zbutur, duke u nisur nga fakti që ‘normalizimi’ pothuajse se është hequr si

²⁰ Politika. 28 tetor 2011. Marrëveshja nxiti reagime dhe vlerësime kundërthënëse [Sporazum izazvao oprecne ocene i reakcije]. <http://www.politika.rs/rubrike/Politika/Sporazum-izazvao-oprecne-ocene-i-reakcije.lt.html>

²¹ B92. 3 korrik 2011. Përshtypja e javës, pjesa e parë [Utasak Nedelje 1 deo]. http://www.b92.net/video/video.php?nav_category=907&nav_id=523143

kërkesë. Serbia po ashtu do ketë përfitim financiar kur bashkëpunimi tregtar do të rritet dhe kur të udhëtojnë kosovarët me veturat e tyre nëpër rrugët e Serbisë.

Reagimet e serbëve të Kosovës

Shumica e përfaqësuesve serbë në komunat veriore kanë reaguar negativisht ndaj marrëveshjeve. Përderisa ata më ekstremistët akuzuan për tradhti, shumica janë ankuar se ata nuk do të mund të përdornin targat e vjetra të UNMIK-ut pasi që ata do të vëreheshin qartazi si serbë në pjesët tjera të Kosovës. Ata po ashtu kanë pretenduar se nuk janë konsultuar apo informuar për politikën e shtetit gjatë dialogut. Situata u përkeqësua pas ngjarjeve në fund të gushtit 2011 që shpjen në marrëveshjen ndërmjet Borislav Stefanoviç dhe komandantit të KFOR-it²² për vendkalimet kufitare. Katër kryetarët e komunave kanë kërkuar shkarkimin e Stefanoviçit nga pozita e krye-negociatorit pasi që ai “ka dëmtuar interesin e serbëve të Kosovës”²³, madje disa prej tyre e kanë kërcënuar edhe fizikisht atë.

Beogradi nuk ka shumë opsione pasi që nuk mund të pranojë se ka dallime ndërmjet lidhshimit serb dhe veriut të Kosovës. Beogradi nuk mund t’i lë serbët e Kosovës pa asistencë financiare pasi që sektori publik dhe ekonomia jo-formale janë i vetmi burim i të hyrave. Beogradi financon institucionet serbe në veri dhe jug, kryesisht spitalet dhe mësuesit, por edhe vetëqeverisjen lokale, postën, universitetin, gjykatat, dhe zyra të ministrive të ndryshme. Sidoqoftë, Beogradi nuk mund të monitorojë dhe kontrollojë si duhet shpenzimin e këtyre fondeve për shkak të mungesës së taksave, si dhe instrumenteve gjyqësore dhe të prokurorisë. Me djegien e pikës doganore në Jarinjë me 27 korrik, kur Beogradi e dënoi sulmin e “huliganëve” u dërgua mesazhi se Beogradi nuk mund të kontrollojë reagimet në veri të Kosovës. Beogradi përhapi thashethemet se trazirat ishin organizuar nga një trafikant nga Mitrovica.

Përderisa shumë serbë mendojnë se kushtet për Kosovën janë rritur me kalimin e kohës, shumë kosovar i shohin kriteret e zbutura për Serbinë, duke u nisur nga fakti që ‘normalizimi’ pothuajse se është heur si kërkesë.

Serbët nga pjesë tjera të Kosovës presin që të përfitojnë më shumë nga Dialogu dhe kanë qenë më përkrahës. Trazirat në veri si ato të korrikut dhe shtatorit 2011, i kanë shtyrë serbët tjerë që të ndjehen më të kërcënuar pasi që ata do të bartnin pasojat e çfarëdo aksioni të bashkatdhetarëve të tyre nga veriu. Po ashtu ka një frikë se në realitet Serbia kërkon ndarjen e Kosovës që rrjedhimisht do t’a bënte Propozimin Ahtisaarit të pavlefshëm dhe do t’i braktisë ata pa garanci politike. Shumë serbë nga jugu thonë që ata ndjenjë “armiçësinë e veriut”. Ky është një moment i rëndësishëm pasi që është nënvizuar nga fakti se serbët nga jugu janë më të integruar në sistemin politik të Kosovës dhe *de facto* e kanë miratuar pakon e Ahtisaarit²⁴. Në të njëjtën kohë, kur serbët e veriut bllokuan sërish rrugët me 16 shtator, sekretari i shtetit në të ashtuquajturën Ministria Serbe për Kosovë dhe Metohi, Oliver Ivanoviç, i ka quajtur serbët e jugut si “pashpjegueshëm pasiv”, dhe u ka bërë thirrje atyre që të përkrahin njerëzit e tyre në veri. Kjo thirrje ishte dënuar publikisht nga udhëheqësit e komunave serbe në jug.

Ngjarjet në veri me 25 korrik prodhuan një ndarje edhe më të thellë ndërmjet serbëve të Kosovës në veri dhe jug. Nuk mund të flitet me për një komunitet të vetëm politik të serbëve të Kosovës. Tani ekzistojnë dy komunitete me interesa, aspirata dhe politikë të ndryshme. Mund të pritët që,

²² Mondo. 17 gusht 2011. Buhler: Marrëveshja vlen deri në vazhdim të dialogut. [Biler: Sporazum vazi do nastavka dijaloga]. http://www.mondo.rs/s215009/Info/Srbija/Biler_Sporazum_vazi_do_nastavka_dijaloga.html

²³ RTS. 5 shtator 2011. Kërkesë për ndryshim – kritika emotive. [Zahtev za smenu - emotivne kritike]. <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/951198/Zahtev+za+smenu+-+emotivne+kritike.html>

²⁴ Gashi, Krenar. Korrik 2010. Rishikimi i procesit të decentralizimit – Funkcionimi i komunave me shumicë serbe. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Analiza Politike 2010/5. http://www.kipred.net/web/upload/Review_of_Decentralization.pdf

përderisa Serbia nuk e ndërron pozicionin e saj, dallimi ndërmjet serbëve në veri dhe jug do të rritet gjatë Dialogut, njëjtë sikurse edhe distanca ndërmjet veriut dhe Beogradit. Natyrisht që kjo varet nëse dhe për sa gjatë do të vazhdojë dialogu, por në rast të ndryshimit në Beograd, serbët e jugut dhe Beogradi mund të shohin motiv më të madh për bashkëpunim.

Fitimet dhe humbjet për komunitetin serb janë më të vështira për t'u vlerësuar. Së pari, serbët në veri dhe ata në jug kanë evoluar të kenë interesa të ndryshme. Serbët në veri e shohin si më realist opsionin për të mbetur me Serbinë, dhe shohin më shumë përfitime nga kjo perspektivë. Kjo është si rezultat i jetesës në 12 vitet e fundit më tepër në sistemin legal-ekonomik të Serbisë sesa të Kosovës dhe që pak a shumë është toleruar nga bashkësia ndërkombëtare. Serbët në jug në masë të madhe kanë hequr dorë nga të qenit pjesë e Serbisë dhe i shohin përfitimet nga dy perspektiva: (a) për të shtuar në maksimum përfitimet, dhe (b) ata që mendojnë që përfitimet aktuale janë të përkohshme kështu legalizimi i tyre në fakt është një fitim real.

Për të kuptuar përfitimet e sakta duhet bërë një analizë në detale e ndryshimeve të pritura. Pasi që të rregullohen vështirësitë e mundshme, serbët në jug nuk do të kenë nevojë të ndryshojnë targat e tyre. Për herë të parë ata do të mund të udhëtojnë në Serbi pa ndryshuar targat, por shumë prej tyre do t'ju duhet të bëjnë ashtu pasi që është më lirë. Shumë serbë e kanë kuptuar që targat KS do t'i bëjnë ata të dallueshëm si serbë. Përderisa situata e sigurisë është përmirësuar dukshëm, shumica më parë do të merrnin targat RKS kur të shkonin në Serbi po të mos ishte ky variant më i kushtueshëm. Mbajtja e targave të vjetra më tepër është një vendim emocional, por po ashtu edhe financiar, pasi që shumica e serbëve nuk i kanë regjistruar fare makinat e tyre në dekadën e fundit dhe kanë shpenzuar shumë më pak në sigurim, taksa rrugore dhe obligime tjera. Duke ju falënderuar detajeve të diskutuara, serbët do të mund shmangnin taksat e dyfishta për makinat që ata aktualisht i ngasin. Ata kështu gjithashtu u ikin problemeve me institucionet e Kosovës.

Targat KS do të lehtësojnë udhëtimin brenda Kosovës për serbët e veriut. Do të ketë më shumë sundim të ligjit në tërë Kosovën por kjo më së shumti do të vërehet në veri. Sidoqoftë, liderët e serbët të veriut hezitojnë për të parë ndonjë ndryshim nga frika se zgjidhja e situatës e dëmton situatën e tyre të veçantë dhe e rrezikon shndërrimin e tyre në një zonë të izoluar periferike, qoftë të Serbisë apo të Kosovës. Ata po ashtu mund të humbin ndihmat e shumta financiare nga Serbia. Pak serbë dëshirojnë që të heqin dorë nga rrogat e larta serbe për ato të Kosovës të cilat janë disa herë më të vogla. Të gjithë serbët që kanë nevojë për dokumente të Kosovës do të mund dëshmojnë të drejtën e tyre për shtetësi përmes kopjeve të regjistrat civil.

Serbët e 'jugut' pak a shumë e kanë pranuar Ahtisaarin. Përfaqësuesit politik të "jugut të Kosovës" janë të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës, përderisa të gjitha qeveritë lokale punojnë bazuar në planin e Ahtisaarit. Përveç përfitimeve praktike, ato po ashtu janë përkrahës për Dialogun duke shpresuar që me përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës do të fuqizojnë edhe pozitën e tyre. Pavarësisht kontakteve personale me liderë të rëndësishëm serbë, përfaqësues të SLS (Partia e Pavarur Liberale) që janë në Qeveri të Kosovës nuk janë zyrtarisht të njohur nga Qeveria e Serbisë si përfaqësues të serbëve të Kosovës dhe shtypi i Beogradit shpesh i quan ata si "serbë të Thaçit".

Mbi të gjitha, serbët e Kosovës duket që do të fitojnë më së shumti nga Dialogu, por janë më së paku të përfshirë dhe të frikësuar që BE-ja në rend të parë i konsideron preferencat e Prishtinës dhe Beogradit mbi ato të serbëve të Kosovës. Krejt në fund, ata pritet të përfitojnë nga normalizimi, por mbetet e paqartë se çfarë përfshin ajo.

Çfarë është 'normalizimi'?

Një nga detyrat kryesore të dialogut, dhe presion i të dy palëve është normalizimi i marrëdhënieve të tyre. Çka nënkupton kjo në praktikë? Normalizimi mund të nënkuptojë gjetjen e një *modus vivendi* për marrëdhëniet Kosovë-Serbi, përjashtuar njohjen, nga udhëtimi dhe tregtia, telekomunikimi,

shërbimet postale, kontrolli i kufirit, transporti hekurudhor, kultura, sporti, energjia, etj. Ekzistojnë shembuj të entiteteve që kanë bashkëpunuar pa e njohur njëra tjetrën. Ideja fillestare është që mund të mendohet është që ‘normalizimi’ është çfarë ne e quajmë ‘zbrazje’ e kovës së statusit. Një numër i çështjeve që janë interpretuar si të lidhura me statusin janë depolitizuar para një kohe të gjatë, dhe ka gjasa që edhe të tjera të depolitizohen, dhe të shkëputen nga statusi.

Kategoria e parë (shih grafikun në faqen tjetër) paraqet një listë të çështjeve që janë depolitizuar dhe zgjidhur në të kaluarën. Dialogu aktual ka arritur që të depolitizojë dhe të arrijë marrëveshje për disa çështje të quajtura si ‘në proces të shkëputjes nga statusi’ (kolona e dytë). Një numër i çështjeve tjera aktualisht janë të lidhura me statusin, por nuk kanë nevojë që të konsiderohen si të tilla (kolona e tretë). Ne argumentojmë që ato mund të trajtohen si tema që nuk kanë të bëjnë me statusin në mënyrë që të shpiejnë drejt normalizimit. Janë disa çështje tjera strikte që akoma nuk mund të depolitizohen si: demarkacioni i kufirit, njohja, etj.

‘Zbrazja’ e kovës së statusit.

Figura më poshtë ilustron evoluimin e çështjeve nga fazat e para të pas konfliktit (për listën e parë) kur çdo gjë ishte politike në depolitizimin gradual. Për shembull, çështja e personave të zhdukur ka qenë mjaft e politizuar, e përdorur dhe keqpërdorur për vite, sidoqoftë, ajo tani trajtohet si humanitare. Kosova për një kohë të gjatë ka pasur vështirësi për të argumentuar që shërbimi policor i saj është adekuat. Ka qenë ironike pasi që Kosova si krahinë gjatë viteve ‘80 ka pasur forcën e saj policore, por sot Serbia nuk e konteston të drejtën e Kosovës për të pasur policinë e saj dhe nuk i dekurajon më serbët që të bëhen pjesë e kësaj force. Çështja e pagesës së faturave të energjisë elektrike dhe marrja e dokumenteve personale me emblemë të Kosovës nuk konsiderohet më si e lidhur me statusin.

Normalizimi mund ta zbrazë në tërësi kategorinë e çështjeve të lidhura me statusin, dhe adresimi i statusit më vonë mbetet vetëm çështje emocionale.

Kjo lëvizje e çështjeve nga ‘kategoria e statusit’ në një ‘kategori praktike ka ndodhur në mënyrë shumë të ngadalshme, sikurse që nuk është duke shkuar shpejt as lista e re që është duke u diskutuar. Kërcënimi kryesor është që kjo ndalohet për shkak të nevojës për të siguruar që procesi siguron shtytje të mjaftueshme për të dyja palët për të mbajtur tempon dhe për të mos lënë prapa opinionin publik.

Nuk duhet shumë imagjinatë për të parë listën në kolonën e tretë si krejtësisht teknike. Pak çështje do të mbesin si krejtësisht të lidhura me statusin të cilat ndoshta do të trajtohen në një kohë kur Kosova dhe Serbia janë më të gatshme që të kenë marrëdhënie me njëra tjetrën. Në aspektin afatgjatë, normalizimi mund ta zbrazë në tërësi kategorinë e çështjeve të lidhura me statusin, dhe adresimi i statusit më vonë mbetet vetëm çështje emocionale. Për t’u siguruar që ky momentum e mban hapin, një raport strikt kushtëzues të karotave dhe shkopit është i domosdoshëm.

Shkëputja e çështjeve nga statusi

Pothuajse të depolitizuara

Personat e zhdukur

Serbët në Policinë e Kosovës

Pagesa e rrymës nga serbët e Kosovës

Pranimi i decentralizimit dhe komunave nga serbët në jug

Marrja e dokumenteve të lëshuara nga institucionet e Kosovës

Pranimi i fondeve për projekte dhe administratë nga institucionet e Kosovës

Në proces të shkëputjes nga statusi

Regjistrat kadastral

Regjistrat Civil

Vulat doganore

Pranimi i përbashkët i letërnjoftimeve dhe targave të veturave

Pranimi i përbashkët i sigurimeve

Pranimi i përbashkët i diplomave universitare

Telekomunikacioni

Energjia

Përfaqësimi rajonal dhe ndërkombëtar në Kosovë

Duhet akoma punë për t'u shkëputur nga statusi

Sportet. Precedenti i Skocisë, Uellsit, Irlandës së Veriut dhe pjesëve tjera mund të shërbejë për të bindur Serbinë që të lejojë Kosovën për të garuar në sportet ndërkombëtare.

Posta dhe shërbimet postare

Bashkëpunimi praktik. Kontakte dhe bashkëpunim të rregullt në çështjet me shqetësim të përbashkët dhe ndërmjet institucioneve që nuk lidhen me statusin: policia, gjykatat, shëndeti publik, uji apo degradimi ambiental.

Infrastruktura. Kosova dhe Serbia të ndërtojnë rrugët kryesore që i lidhin me njëra tjetrën.

Shkëmbimet kulturore

Transporti hekurudhor

Transporti ajror (përfshijë hapësirën ajrore)

Trashëgimia kulturore

Anëtarësimi i Kosovës në institucione të ndryshme ndërkombëtare

Decentralizimi i Kosovës në veri

Kushtëzimi bilateral

Ky proces nuk do të kishte ecur përpara po qe se BE dhe SHBA nuk do të rrisnin skemën stimuluuese dhe të shërbenin si garantues. Në fakt ata kanë shkuar edhe disa hapa para, raportohet se shpesh edhe duke i kërcënuar palët se do t'ua shkatërrojnë karrierën politike nëse ata nuk lëvizin sa duhet përpara. Dialogu qartazi është bërë pjesë e raporteve të progresit, që të gjitha shtetet e Ballkanit i përdorin si barometra të efikasitetit të qeverive të tyre.

Kur dialogu po dështonte në mes të shtatorit, Robert Cooper, ndërmjetësuesi i BE-së në dialogun Prishtinë-Beograd, u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të kuptojnë faktin që Beogradi ka dështuar të zbatojë marrëveshjet dhe të presin deri sa BE-ja vlerëson performancën e Serbisë në proces. Cooper e ka përgëzuar Kosovën për zbatimin korrekt të marrëveshjes së vulave dhe ka shprehur shqetësime që Serbia akoma nuk ka filluar zbatimin. Ai i ka bërë thirrje Kosovës që të ketë mirëkuptim edhe për disa ditë deri sa BE-ja të bëjë vlerësimin e performancës së Serbisë për çështjen në fjalë²⁵.

Një rezultat që Prishtina e ka dëshiruar për një kohë të gjatë ka qenë liberalizimi i vizave, dhe tërheqja e udhëtimit pa viza është rritur edhe më shumë pasi që të gjitha vendet fqinje e kanë fituar këtë. Kosovës nuk i është ofruar udhërrëfyesi, në rend të parë për shkak të mosnjohjes nga pesë vende anëtarë të BE-së. Shumica e kosovarëve besojnë që arsyeja e vërtetë për mosdhënien e udhërrëfyesit ka qenë zgjedhja e BE-së që t'a përdorin këtë si mjet për ta shtyrë Kosovën në dialog. Dyshimet se a i ka përmbushur Kosova kriteret u hoqën nga deklarimi i ambasadorit gjerman në Prishtinë Ernst Reichel: "Gjermania ka ardhur në përfundim se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për të filluar Dialogun për liberalizim të vizave me BE. Gjermania do mbajë këtë qëndrim edhe në BE"²⁶.

Gjermania insiston që Komisioni Evropian të vendos kushte strikte mbi marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën në shkëmbim të marrjes së statusit të kandidatit.

Ajo (Angela Merkel) shkoi në zyrën e presidentit serb, Boris Tadiq, dhe gjatë bisedimeve për integrim në Bashkimin Evropian, i bëri të qartë se loja politike e Serbisë në Kosovë ka marrë fund. Kosova nuk do të ndahet; se zona e banuar me serbë në veri të Lumit Ibër është territor i Kosovës. Serbia duhet të ndalojë përzierjen në atë pjesë dhe se çështja e Kosovës duhet të zgjidhet para se Serbia të mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian²⁷.

Burime diplomatike të cituara nga ditorja beogradase Blic, kanë thanë që Serbisë i është kërkuar që të vazhdoj dialogun me Kosovën në çështjet e:

1. Vazhdimin e dialogut pa kushte;
2. Paraqitjen rajonale të Kosovës;
3. Telekomunikacioni dhe energjia;
4. Shpërbëjë institucionet paralele në Kosovë që më konkretisht ka nënkuptuar që Prishtina merr gjykatat në veri dhe të fillojë shpërbërjen e strukturave paralele.

Përderisa kushtëzimi u shpreh troç nga kancelarja gjermane Angela Merkel, ai kërkon më pak se 'normalizim'. Niveli i përkrahjes së pozicionit të Gjermanisë mbetet i paqartë, përveç Britanisë dhe Holandës. Një tjetër raport i vendos tri kushte që përcaktojnë rezultatin e diskutimeve të kancelares: rifillimi i dialogut, dorëzimi i gjykatës në veri të Mitrovicës dhe shpërbërja e institucioneve në veri. Jo

²⁵ Express. 26 shtator 2011. Cooper: Keni pak më shumë durim.

²⁶ Koha Ditore. 24 shtator 2011,

http://newsmonitors.org/mon/index.php?option=com_content&view=article&id=596:saturday-report-24-09-2011&catid=37:saturday.

²⁷ Abramowitz, Morton dhe James Hooper. 20 shtator 2011. Ultimatum i BE-së ndaj Serbisë. [Serbia's EU Ultimatum]. PILPG Update botuar në The National Interest.

të gjitha vendet insistojnë në të njëjtën gjë. Italia beson që negociatat ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të rifillojnë. Kjo nuk është një kusht për kandidim por do të përmirësonte atmosferën²⁸. Vende të tjera shpesh janë edhe më miqësor me Beogradin. Ministri i punëve të jashtme të Suedisë tha në Luksemburg para takimit të ministrave të BE-së, "Autoritetet e Beogradit kanë pak ndikim në ngjarjet në veri"²⁹. Parisi kërkon pak më shumë sesa kthimi në tavolinën e negociimit³⁰.

Për të marrë statusin e kandidatit, qeveria e Serbisë duhet të bëjë thirrje të qartë për largim të barrkadave në veri, pasi që pa ndodhur kjo nuk mund të zbatohet marrëveshja për vulat doganore, ka nënvizuar Jelko Kacin, Raportues Special në Parlamentin Evropian për Serbinë. Kacin po ashtu ka thënë se Gjermania vetëm thotë opinionin që e mendojnë së 22 vende anëtare që e kanë njohur Kosovën³¹. Për të treguar që kushtëzimi nuk është hequr pas një gjuhe të butë të BE-së në Raportin e Progresit, ambasadori gjerman në Kosovë ka thënë që:

"Rekomandimet e BE-së për Serbinë janë vetëm rekomandime. Qëndrimi i Gjermanisë është i qartë. Ai është shprehur nga (Angela) Merkel në Beograd. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që të gjitha rekomandimet e BE-së duhet të plotësohen. Megjithatë, ne do ta themi qëndrimin tonë zyrtar në dhjetor se a jemi në favor të statusit të kandidatit të Serbisë."³²

Çfarë duhet bërë Serbia për ta kënaqur Gjermaninë mbetet për tu diskutuar nga administratat e këtyre dy vendeve pas dyerve të mbyllura deri më 9 dhjetor. Obrad Kesiq beson që Britania dhe Gjermania janë pakicë në mesin e vendeve të BE-së, ku shumica as nuk e kupton se pse ka qenë i nevojshëm një eskalim i situatës në veri të Kosovës dhe me kënaqësi do të pranonin një zgjidhje që kthen situatën në gjendjen e mëparshme, që do të thoshte që pavarësia e Kosovës të forcohej me anë të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe jo përmes përdorimit të forcës³³. Në mesin e shumë ndarjeve, më seriozja duket ajo në mes të ShBA-së dhe BE-së, shumë anëtarë të së cilës ishin të befashuar me kohën e krejt asaj që ka ndodhur sa i përket destabilizimit të veriut të Kosovës³⁴.

Në të njëjtën kohë, duhet të kihet parasysh që për shkak të pasigurisë në progresin e rrugës evropiane, si interpretohet integrimi evropian në Serbi, kushtëzimit të shtuar, euro-skepticizimi në mesin e qytetarëve të Serbisë është në rritje. Vlerësohet se për shkak të një numri të madh të pengesave, madje edhe statusi i kandidatit mund të merr një përgjigje të vakët në publik. Në të njëjtën mënyrë, analistë të tjerë parashohin që kjo qasje e vakët vlen edhe kundrejt humbjes së Kosovës, e cila nuk shihet më si diçka që shkakton probleme.

Serbia definitivisht është e kënaqur nga opinioni i Komisionit. Kryeministri serb ka deklaruar që Serbia ka shmangur kushtet e pamundshme për Kosovën". Kërkohet progres në dialogun me Prishtinën në (për arritjen e statusit të kandidatit, por edhe të fillimit të negociatave) çështjet teknike, që janë neutrale ndaj statusit. Nuk kërkohet shpërbërja e të ashtuquajturave institucione paralele e as zgjedhjet e reja lokale³⁵. Zv-Kryeministri serb, Bozhidar Xheliq ka thënë se Serbia ndoshta e ka marrë opinionin më të mirë nga Komisioni Evropian dhe ka shmangur kushtet që nuk janë në harmoni me kushtetutën serbe dhe politikën shtetërore në Kosovë. Xheliq ka thënë që fakti se 22 shtete të BE-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës nuk mund të jetë pa ndikim në integrimin evropian të Serbisë.

²⁸ Deutsche Welle. 11 tetor 2011. Kosova "çelësi" për Europë?

²⁹ Vecernje Novosti. 11 tetor 2011. Bildt: Beogradi nuk është përgjegjës për problemet në veri të Kosovës.

³⁰ Vecernji Novosti. 12 tetor 2011. BE-ja kushtëzon me Kosovën

³¹ Danas. 17 tetor 2011. Gjermania është duke thënë atë çfarë 22 vendet anëtare të BE-së janë duke e menduar.

³² KTV. 13 tetor 2011. Ambasadorët e jashtëm në Kosovës komentojnë raportin e progresit.

³³ Nikoliq Xhakoviq, Tanja. 13 tetor 2011. Skenari për Kosovë: Ngrirja e konfliktit. [Kosovski Scenariji: Zamrzavanje Konflikta]. NIN. <http://www.nin.co.rs/pages/article.php?id=63747>.

³⁴ Po aty.

³⁵ Intervistë me Bozhidar Xheliq, zv-Kryeministër për integritet evropian: Ne i shmangëm kushtet e pamundura për Kosovën (*Politika*) 13 tetor 2011 Tani çka kërkohet nga Serbia është dialogu me Prishtinën?

Neve nuk na kërkohet që të njohim drejtpërdrejtë apo në mënyrë indirekte Kosovën, por vetëm të normalizojmë marrëdhëniet për çështjet teknike, siç janë çështjet si telekomunikacioni, furnizimi me energji dhe diplomat e shkollave. Nëse do të ketë vullnet të mirë, kjo mund të arrihet³⁶.

Një analizë është që Serbia kërkon të blejë kohë. Kjo do të thotë që Serbia nuk do të ngutet që ta përmbush këtë kusht, dhe duke pasur parasysh mungesën e apetitit në BE për integrim, BE-ja nuk do të ushtrojë më presion, por do të presë që Serbia të bëjë hapa konkret duke toleruar vonesa të konsiderueshme. Afati kohor është për verën apo vjeshtën e vitit të ardhshëm. Megjithatë, ka një mundësi që Beogradi të dëshiroj të caktoj një datë për negociatave me BE-në dhe do të konsideroj që disa pjesë të agjendës së dialogut si çështja e energjisë, telekomunikacioni, etj., janë të mundshme. Në anën tjetër, gjërat si gjykata në veri të Mitrovicës dhe pjesëmarrja e Kosovës në forumet rajonale janë më së paku të pranueshme për Beogradin dhe do të marrin kohë të konsiderueshme. Siç tha Stefan Fule,

Ne konsiderojmë që Serbia duhet të bëjë përpjekje vendimtare për të arritur rezultate shitesë në dialogun Beograd-Prishtinë. Kjo, si një prioritet, përfshin zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Është e nevojshme që të sigurohet parimi i bashkëpunimit rajonal gjithëpërfshirës, përderisa sa i përket sferës së energjisë dhe telekomunikacionit zgjidhjet duhet të identifikohen në vijë me trashëgiminë evropiane. Bashkëpunimi aktiv me EULEX-in do të jetë i rëndësishëm së veçantë. Kjo është kryesorja në arritjen e kushteve për procesin e Stabilizimit Asocimit dhe përfundimisht të fillohen negociatave e para-anëtarësimit me Serbinë³⁷.

Për të hapur rrugën më tutje, Fule propozoi hapjen e negociatave të para-anëtarësimit sa më shpejt që Beogradi bën progres të mëtutjeshëm në arritjen e prioritetit kryesor që është bërja e hapave tjerë për normalizimin e marrëdhënieve me Prishtinën në pajtim me kushtet e Procesit të Stabilizimit Asocimit.

Njohja e Kosovës nuk është një kusht formal për procesin e integritet evropian të Serbisë. Në një të ardhme të afërt duhet të gjenden zgjidhje për një numër të çështjeve të hapura që vazhdojnë t'a pengojnë normalizimin e marrëdhënieve³⁸.

Opozita më e zëshme në Kosovë e ka problem injorimit të faktit se kushtetuta e Serbisë akoma e trajton Kosovën si pjesë të territorit të saj³⁹. Më shumë ngjarje të pritura e të papritura mund të ndodhin dhe të ndryshojnë dinamikën. Një numër i tyre që mund të largojnë dialogun nga vëmendja kryesore janë identifikuar më poshtë.

Rreziqet në horizont

Se a do të ketë dialogu sukses varet po ashtu nga një numër i faktorëve dhe ngjarjeve (të planifikuara dhe të pa-planifikuara) që mund të formësojnë motivin e palëve të përfshira. Një numër i çështjeve mund lehtë të parashihen. Skenari që Prishtina do intervenojë njëanshëm me një operacion të ngjashëm me atë kroat 'Stuhia' ka pak gjasa të ndodh sikurse që ka pak gjasa të ndodhë edhe një konferencë ndërkombëtare për veriun. Por tema e veriut do të sjellë shumë zyrtarë për të vizituar Kosovën dhe Ballkanin. Nuk është e qartë se në çfarë mase Serbia do të llojë kundër pjesëmarrjes ndërkombëtare të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Ne jemi përpjekur që të parashohim disa nga ngjarjet më poshtë.

³⁶ Radio Serbia. 19 tetor 2011. Xheliq: integrimet evropiane të lidhura me çështjen e Kosovës.

³⁷ Vecernje Novosti. 14 tetor 2011. Fule: Njohja e Kosovës nuk është kusht.

³⁸ Po aty.

³⁹ Kurti, Albin. 27 tetor 2011. Shqetësim me konkluzionet dhe rekomandimet. Koha Ditore. f. 10.

Dy ngjarje që kanë mundur të prishin dialogun janë:

Organizimi i regjistrimit të popullsisë në veri. Barrikatat shërbyen si një arsye i mirë për të mos organizuar regjistrimin e popullsisë në veri. Mbjajtja e regjistrimit nga autoritetet beogradase do të kishte dërguar një sinjal të keq. Për dallim nga ide të ndryshme të dhëna më herët që organizatat ndërkombëtare të bëjnë një regjistrim të besueshëm, ne rekomandojmë që mos të bëhet fare regjistrim. Të dhënat dhe informatat e nevojshme për veriun e Kosovës për qëllime ndërkombëtare ekzistojnë si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë.

Opinionin në fillim të tetorit për integrim të Serbisë ka qenë më i mirë sesa që është pritur, duke rritur në Prishtinë frikën se më pak po kërkohet nga Beogradi. Opinioni ka integruar pritjet se çfarë duhet të bëjë Serbia dhe përderisa kërkesat janë të vogla, ato tani zyrtarisht priten nga institucionet e BE-së. Opinioni i datës 9 dhjetor do të ketë ndikim në dialogun në mënyrë që bisedimet mund të vazhdojnë pas kësaj date por pa ndonjë marrëveshje deri në fund të verës së vitit të ardhshëm.

Çfarë mund të pengojë akoma dialogun në të ardhmen?

1. Mungesa e zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani. Shpesh thuhet se djalli fshihet në detaje, por niveli i mosmarrëveshjeve që e ka përshkruar procesin është mjaft i lartë. Shkaqet mund të jenë të ndryshme, nga qëllimet e pasinqerta, dallimet e mëdha, presioni i brendshëm, ndryshimi i mendjes, papranueshmëria publike dhe mungesa e vullnetit politik. Kjo mund të dëmtojë besimin e ndërsjellë dhe të vështirësojë arritjen e marrëveshjeve të ardhshme. Ndërmjetësuesi i BE-së dhe delegacioni i SHBA-së duhet të bëjnë çdo gjë që është e mundur për të bindur të dy palët se është në interesin e tyre për të biseduar në mënyrë të sigurtë dhe të ngutën në arritjen e disa rezultateve të qarta. Mosmarrëveshjet për 'detajet' do të ofrojnë hapësirë për kritikë më të madhe nga opozita, që ka gjasa të mëdha të ndodhë dhe me efekt të lartë.

2. Vonesat në marrëveshje shtesë për çështjet si telekomunikacioni, energjia dhe përfaqësimi i Kosovës në mekanizmat e përfaqësimi trajonal. Një marrëveshje tjetër sikurse edhe një implementim i plotë dhe me kohë i asaj që është arritur deri më tani do të mbajë vrullin, në rast të kundërt, Kosova dhe Serbia do të jenë më keq se ku kanë filluar dhe opinioni publik do të ngritet kundër.

3. Vendimi zyrtar për kandidimin e Serbisë do të bëhet publik në fillim të dhjetorit dhe mund të shënojë fundin e një procesi çfarë kemi tani. BE duhet të mendojë me kujdes për karotat e mbetura që ndikojnë në sjelljen e Prishtinës dhe Beogradit përgjatë kësaj kohe. Përderisa bisedimet mund të vazhdojnë pas dhjetorit, mundësia tjetër për të arritur ndonjë marrëveshje do të jetë vetëm pas 10 muajsh, në shtator të vitit 2012, pas formimit të qeverisë të re në Serbi, kur fillimi i datës së negociatave për anëtarësim në BE do të jetë qëllimi i radhës. Frika për një rezultat asimetrik më së miri ilustron nga një editorialist i Kohës Ditore që tha se Beogradi e mban në duart e veta fatin e Kosovës drejt BE-së. Ai thotë që mesazhi nga Brukseli është i qartë. Serbia nuk është e obliguar ta njohë Kosovën për t'u bërë anëtar i BE-së, por Kosova nuk mund të bëhet anëtare e BE-së pa njohjen nga Serbia dhe pesë vendet tjera anëtare. Kelmendi thotë që kjo është një situatë e pashpresë për Kosovën ndërsa qeveria është duke e fshehur të vërtetën dhe duke u lavdëruar me mundësinë e heqjes së vizave për udhëtim⁴⁰.

4. Mbjajtja e zgjedhjeve serbe në veri të Kosovës. Zgjedhjet në Serbi po afrohen dhe mbajtja e tyre në veri të Kosovës do të shkatërronte të gjithë progresin e arritur deri më tani. Serbia mund të provojë organizmin e tyre që të provokojë ndonjë reagim nga Kosova, por mosmbajtja e tyre mund të ulë popullaritetin e qeverisë. Është po ashtu e mundur që zgjedhjet të mbahen para kohe edhe pse kjo ka pak gjasa të ndodhë. Nëse zgjedhjet lokale organizohen në pranverë, ajo do të rezultoj me

⁴⁰ Kelmendi, Adriatik. 20 tetor 2011. Koha Ditore.

fuqizimin e institucioneve të Kosovës në veri⁴¹. Për të shmangur një skenar të tillë, është thelbësore që strukturat paralele të shpërbëhen përmes një marrëveshje e cila po ashtu e arsyeton Beogradin për mos organizim të zgjedhjeve në Serbi.

5. Mos arritja e kushteve për ‘normalizim’. Nëse kushtëzimi bilateral mbetet ashtu siç është tani, Beogradi duhet të shpërbëjë gjykatën në veri para dhjetorit. Gjykata nuk ka gjasa të merret me dhunë. Një skenar i dhunshëm është trumbetuar nga politikanë të ndryshëm në Serbi që kanë parashikuar një operation kosovar që i ngjan “Stuhisë” kroate, por ekspertët kosovarë mendojnë se është pikërisht një reagim i tillë që mund të shpie në një shkallë më të madhe të autonomisë për veriun⁴². Përderisa kushtëzimi është i përshtatshëm për të ofruar disa rezultate, ai po ashtu mund të inicioj reagime dhe shkatërroj disa nga arritjet e bëra.

6. Jostabiliteti i mundshëm institucional në Kosovë. Mungesat buxhetore mund të nxisin një krizë të madhe që mund të provokonte pakënaqësi publike. Kjo mund të ndodhë në çdo kohë, por probabiliteti rritet sa më shumë që shkojmë në fund të vitit si dhe në vitin e ardhshëm, veçanërisht nëse nuk arrihet të shitet PTK-ja dhe të ipet koncesioni për projektin energjetik Kosova e Re.

7. Periudha më e rrezikshme vjen pas dhjetorit. Tundimet për t’u futur në politikë populiste do të jenë shumë të larta në Serbi për shkak të periudhës zgjedhore, përderisa Prishtina do të jetë shumë e dëshpëruar për mosmarrjen e marrëdhënieve kontraktuale. Rezultatet zgjedhore në Beograd do të ndikojnë bisedimet por jo edhe aq shumë. Madje as një qeveri e SNS-së (Partia Nacionaliste Serbe) nuk do të braktiste dialogun.

8. Destabilizimi dhe veprimet reciproke (tit-for-tat) në veri ka gjasa mesatare të ndodhin por me ndikim të madh. Politikat e reciprocitetit në teren mund të ndiqen dhe ndoshta serbët do të shkyçin fshatrat shqiptare nga rrjeti elektrik apo do t’ju bëjnë presion, e në anën tjetër incidente mund të ndodhin në jug të Kosovës. Shantazhimi i Serbisë ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në forume të ndryshme do ta irritojë Prishtinën e cila do të shohë një Beograd dyfyturësh që do të dëmtojë besueshmërinë.

Beteja për një garë bukurie: BE-ja është juria

Krahas Kosovës dhe Serbisë ka edhe aktorë tjerë të përfshirë në procesin e Dialogut, në rend të parë BE dhe SHBA, e para po ashtu ka edhe rol udhëheqës në bisedime si “lehtësues” zyrtar. Për shkak të rolit që luan BE-ja, të gjitha vendet e BE-së kanë ndikim në bisedime, duke anashkaluar Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Catherine Ashton, duke e shndërruar dialogun në një proces në mes të më shumë se dy palëve. Departamenti i Shtetit është i përfshirë ngushtë në Dialog dhe përfaqësuesi i tyre është gjithmonë i përfshirë në takimet në Bruksel por në rol këshillues. Prania e këtyre dy faktorëve krijon një situatë ku Kosova dhe Serbia nuk kanë gjasa që të refuzojnë dialogun. Duke pritur që pala tjetër nuk do bëjë lëshime thelbësore, strategjitë e tyre kanë qenë që të bijnë në sy dhe të paraqesin vetën e tyre “si negociator konstruktiv me stil evropian”. Ka një perceptim tek të dy palët se ‘fitues i dialogut’ është pala që tingëllon më shumë “evropiane”, në kuptimin e marrëdhënieve me publikun. Doris Pack, Kryesuese e Komisionit për Evropën Juglindore

Kur dialogu u ndal, Beogradi dhe Prishtina bënë çdo gjë për të komunikuar storien e tyre tek BE-ja se ata ishin për dialog por ka qenë pala tjetër që e ka ndaluar atë.

⁴¹ Politika. 14 tetor 2011. Intervistë: Laslo Varga, Kryetar i Komisionit për Integritet Evropian: Dy kushtet e Komisionit Evropian nuk janë status- neutral.

⁴² Politika. 23 shtator 2011. Kryetarët e komunave veriore të Kosovës parashohin provokime nga Prishtina.

në Parlamentin Evropian i është referuar kësaj çështje kur ka thënë që “Dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nuk duhet të jetë vetëm një shou”⁴³.

Ndikimi i BE-së dhe SHBA-së është parakusht për të ndodhur dialogu. SHBA-ja mund të ketë ndikim në Kosovë por më pak në Serbi, përderisa është e kundërta për Serbinë. Në fakt, të dy palët nuk kujdesen për mirëqenien e palës tjetër por motivi kryesor është “shpërblimi politik” ose nga BE-ja ose nga SHBA-ja. Rreziku është që njëra palë mund të iniciojë “një lojë faji” ku njëra palë mundohet ta provokojë palën tjetër me masa të njëanshme kështu që pala tjetër e lëshon dialogun në formë proteste. Pala tjetër mundet të mos e lëshojë tryezën e bisedimeve por të përgjigjet edhe ajo me masa të njëanshme. Në këtë mënyrë Dialogu do të humbte fokusin dhe tërheqja e BE-së mund të duket si një shtëpi e letrave.

BE-ja dhe SHBA-ja do të duhej të ishin më këmbëngulës në mbrojtjen e Dialogut dhe më dinamik në kërkesën për të lëvizur përpara. Sidoqoftë, Kosova dhe Ballkani Perëndimor nuk janë më prioritet i lartë për SHBA-në dhe mos-uniteti i BE-së dhe kriza që e ka kapluar e dëmtojnë aftësinë e saj për të ndikuar. Kriza financiare dhe borxhi publik evropian, lufta në Libi, “pranvera Arabe”, rezoluta e OKB-së për Palestinën, etj., e kanë ulur interesimin për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Vizita e Angela Merkel dhe mesazhi i saj i fortë për Beogradin ka lënë të supozohet se SHBA-ja ka lënë Gjermanisë që të udhëheq me Kosovën prandaj edhe kemi lëvizje të shpejtë të gjërave në muajt e fundit.

Është më mirë që të kemi bashkëpunim të pasinqertë sesa luftë të singertë. Koha do ta bëjë të veten dhe marrëdhëniet e Serbisë dhe Kosovës gradualisht mund të përmirësohen. Të shtiremi deri sa të funksionoi!

Shumë nga sjelljet e të dy palëve i atribuohen ndërmjetësuesit të BE-së (jurisë). Është interesante të shihet se pa marrë parasysh preferencat e vërteta, politikanët shpesh thonë që ‘dialogu është e vetmja zgjidhje’, madje edhe kur ata janë në dyshim se për çfarë dialogu janë duke folur. Kur dialogu u ndal, Beogradi dhe Prishtina bën çdo gjë të mundur për të komunikuar storien e tyre tek BE-ja se ata ishin për dialog por ka qenë pala tjetër që e ka ndaluar atë.

Mbi të gjitha, në mungesë të shtytjeve të vërteta, në ndërkohë gara e bukurisë mund të shërbejë. Është më mirë që të kemi bashkëpunim të pasinqertë sesa luftë të singertë. Koha do ta bëjë të veten dhe marrëdhëniet e Serbisë dhe Kosovës gradualisht mund të përmirësohen. Të shtiremi deri sa të funksionojë!

Besimi reciprok dhe kredibiliteti

Dy palët dialoguese duhet të këshillohen që të mendojnë me kujdes jo vetëm përballë votuesve, por edhe kundrejt palës tjetër. Negociatorët nganjëherë i portretizojnë të arriturat e tyre si fitore kryesore dhe mburren për aftësitë e tyre mjeshtërore për të fituar mbi palën tjetër.

Negociatorët nganjëherë i portretizojnë të arriturat e tyre si fitore kryesore dhe mburren për aftësitë e tyre mjeshtërore për të fituar mbi palën tjetër.

Në kohën e globalizimit, mesazhet barten nga media të ndryshme për audiencë të ndryshme pothuajse menjëherë. Pasi që ‘tradhtia e brendshme’ është një problem kryesor për publikun dyshues dhe opozitën e ashpër, është e natyrshme që negociatorët kanë nevojë që në mënyrë sa më vizibile të

shmangin akuzën se nuk kanë mbrojtur si duhet interesat nacionale. Kredibiliteti i tyre përballë palës tjetër rezulton të jetë prioritet i ulët. Por, përvoja e zgjidhjes së konflikteve tregon se kjo duhet të

⁴³ Danas. 25 gusht 2011. Intervistë e Doris Pack.

[http://www.dorispack.de/interviews_1.html?&no_cache=1&tx_ttnews\[tt_news\]=521&tx_ttnews\[backPid\]=39&cHash=d81f0e5c12](http://www.dorispack.de/interviews_1.html?&no_cache=1&tx_ttnews[tt_news]=521&tx_ttnews[backPid]=39&cHash=d81f0e5c12).

merret më së tepërmi në konsideratë, veçanërisht në një proces të mbyllur si ky i cili pjesërisht izolon ekipet nga publiku i tyre respektiv.

Si mundën të dy palët të transformojnë perceptimin e interesit vetanak, nëse ata e paketojnë angazhimin e tyre si përpjekje për të nënshtruar, fituar dhe mashtruar palën tjetër? Po të mos garantohej kredibiliteti nga presioni i BE-së (por pak besojnë që BE-ja është plotësisht konsistente) dukja si kuazi-patroit në publik për të shmangur mbikëqyrjen e afërt dhe presionin publik do të bëhej strategji.

Nëse ky dialog është i shpejtë, së paku ai duhet të bëjë të mundshme që diskursi mbi armiqësinë të fillojë të zhduket. Që diskursi i armiqësisë vazhdon dhe patriotizmi i madh është se si ta mashtrosh palën tjetër mund të jetë një tendencë natyrale pas tërë asaj që ka ndodhur. Megjithatë, çmimi i dështimit është shumë i lartë. Është e qartë se besimi është humbur tërësisht, derisa të dy palët janë angazhuar në dialog duke i besuar kredibilitetin e procesit një ndërmjetësi të jashtëm (i cili madje e merr edhe përgjegjësinë për pjesët e marrëveshjeve të cilat nuk janë vënë në letër). Në publik, Kosova dhe Serbia prezantohen sikur po i vazhdojnë betejat e vjetra shekullore me finesë diplomatike, derisa brenda sallës së negociatave të dy palët ngajnë një defilimi në një garë bukurie, ku ndërmjetësi i jashtëm me kujdes mat se cila palë është më konstruktive në qasjen e tij.

Si mundën të dy palët ta transformojnë perceptimin e interesit vetanak, nëse ata e paketojnë angazhimin e tyre si përpjekje për të nënshtruar, fituar dhe mashtruar palën tjetër?

Besimi dhe kredibiliteti varen në një shkallë të lartë në imazhin e Kosovës dhe Serbisë në publikun përkatës. Imazhi i Serbisë në fillim filloi të përmirësohet, por kredibiliteti i saj në publikun e Kosovës sërish ka pësuar rënie, dhe është në shkallën më të ulët veçanërisht pas përpjekjeve për ta përdorur dialogun teknik për ta aneksuar veriun e Kosovës. Roli policit të mirë të luajtur nga Stefanoviq në fazat e hershme të Dialogut dhe roli i policit të keq të luajtur nga Jeremiq ishte zëvendësuar nga një agjendë e hapur për ta integruar me forcë veriun në Serbi.

Se ndjenja është reciproke është e qartë, së paku kjo është ajo që Stefanoviq deklaroi me 5 korrik 2011: “Kisha përshtypjen nganjëherë se po bisedoja me njerëz të cilët nuk janë nga i njëjti planet nga jemi ne. Bisedimet ishin tmerrësisht të vështira sepse çdo fjali dhe paragraf që ne prezantua ishte në kundërshtim me shqiptarët”⁴⁴. Por, i njëjti opinion është e qartë se nuk është ndarë me opinionin publik serb, për shumicën e të cilëve Kosova është një kapitull i mbyllur.

Serbët e Kosovës e gjejnë veten në mes dhe besimi i tyre në Beograd është shkatërruar, por besimi i tyre në Prishtinë nuk e ka plotësuar zbrazëtirën e krijuar. Ka rritje të mosbesimit se Prishtina dhe Beogradi do të pajtohen për të trajtuar mospajtimet e tyre duke injoruar brengat e serbëve lokalë. Gjithashtu ka një rritje të mosbesimit në mes të grupeve serbe të veriut dhe jugut të cilët shohin më pak solidaritet për pikëpamjet e tyre kundërshtuese.

Moszbatimi i marrëveshjes së parë në mirëbesim ka kontribuar në ulje të besimit në anën tjetër. Kur kamionët e Kosovës nuk mund të shkonin në Serbi pas marrëveshjes, dhjetëra artikuj u shkruan rreth mashtrimin të cilin Kosova e kishte pësuar nga Serbia⁴⁵. Një pjesë e kosovarëve e shohin Serbinë si përdoruese të dominimit ekonomik si mjet politik. Vazhdimi i bisedimeve është bërë një betejë e vështirë dhe se herën tjetër, hyrja në bisedime mund të paraqesë një pengesë më të lartë se sa që bëri në mars të këtij viti. Fillimi i Serbisë që të mbledhë tatimet në Kosovën veriore⁴⁶ dhe intervenimi i Prishtinës janë shembuj të cituar në kryeqytetet përkatëse si ndryshim i qasjes dhe veprimi i pabesë gjatë dialogut teknik.

⁴⁴ Stefanoviq, Borislav. 5 korrik 2011.

http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=07&dd=05&nav_id=523248

⁴⁵ Express. 23 shtator 2011. Ky nuk është reciprocitet.

⁴⁶ B92. 19 shtator 2011. Mbledhja e TVSH-së në veriun e Kosovës.

Vendimi i Serbisë që ta kthejë veriun e Kosovës në sistemin e saj të taksave dhe futja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) nuk është pranuar nga BE me miratim. Kjo është parë si lëvizje e njëanshme e Serbisë dhe si një shenjë paralajmëruese për një opinion se Beogradi nuk ishte i sigurt në negociata me Prishtinën.⁴⁷ Çdo përpjekje nga Beogradi për të vënë nën kontroll (të drejtpërdrejt ose jo-drejtpërdrejt) Kosovën veriore, shpie tek deklaratimet për ndarjen e Kosovës, që është absolutisht e papranueshme për Brukselin,” citoi Blic një burim të BE-së duke theksuar nuk ekziston asnjë lloj pranimi i sovranitetit serb në veri. I njëjti burim theksoi se çdo reagim i nxituar nga qeveria serbe është një tregues se çështjet janë politike e jo ekonomike.

Mbajtja e hapit

Ashton shprehu pritjet se marrëveshjet do të vihen në praktikë në periudhë sa më të shkurtër të mundshme dhe se dialogu do të prodhojë rezultate në fushat të cilat nuk janë diskutuar deri tani siç janë telekomunikimi, kadastra, vulat doganore dhe energjia. Ekziston frika që ndërprerja e dialogut është indikative e mungesës së vullnetit për dialog të mëtejshëm. Megjithatë, një përfundim i suksesshëm i këtyre bisedave është parakusht për çfarëdo angazhimi tjetër. Është thelbësore që pas zgjedhjeve të ardhshme në Serbi, të dy vendet akoma do të mund të jenë në gjendje të pozicionohen pro dialogut pa nevojën për presion nga komuniteti ndërkombëtar, të tërhequr vetëm nga karotat e procesit të integritetit në BE dhe përfitimet praktike të garës së tanishme për dialog.

Gjithashtu është thelbësore që të dy anët të ndjehen që kanë marrë shpërblimet adekuate nga BE-ja. Çfarë do të merret dhe si do të perceptohet? Nga fundi i dhjetorit, në mënyrë ideale Kosova dhe Serbia do të ishin në:

Kosova	Serbia
Marrëdhënie Kontraktuale me BE-në dhe Udhërrëfyes të Liberalizimit të Vizave Disa përfitime praktike	Statusin Kandidat Disa përfitime praktike

Një periudhë e suksesshme tani do të mund të shpinte tek një proces ku Serbia dhe Kosova shohin një transformim të vërtetë të interesave të tyre vetanake për të nxitur bashkëpunimin me fqinjët e tyre.

Transformimi i interesave vetanake: Nga shuma-zero në interes reciprok

Ndoshta me forcë, por Prishtina dhe Beogradi kanë bërë hapa në vënien e marrëdhënieve më të mira. Një proces i zhurmshëm me përpjekje të shumëfishta për të fituar mbi palën tjetër, dhe jo për ta konsideruar palën tjetër si partner, ka prodhuar megjithatë një situatë ku ato janë pajtuar dhe ballafaqohen me ndëshkim nëse zgjedhin ti ndryshojnë rregullat. Megjithatë, rregullat janë qartazi të ndryshueshme kështu që palët vazhdojnë lobimin që të ndikojnë në to nëpërmjet kanaleve bilaterale. Është më interes të konkludohet që posa ky bashkëpunim i imponuar të ndodhë në të vërtetë, përfitimet do të jenë të bollshme dhe perceptimi i dikujt për interes vetjak mund të ndryshojë. Përmes karotave dhe shkopinjve, Serbia dhe Kosova gradualisht janë detyruar që të lëvizin nga logjika e shumës-zero tek interesi reciprok. Në çdo rast, siç kemi treguar më herët, ky interes është transformuar në të kaluarën. Prishtina në fillim e ka parë decentralizimin si një kali të Trojës, por kjo frikë është larguar. Serbët e shihnin pagesën e rrymës elektrike si tradhti. Është bast i sigurt të parashikohet që Serbia gjithashtu do të mendojë ngjashëm. Të dy palët që nga fillimi ishin të përndjekur nga imazhi i parë i fjalës ‘negociata’, dhe e ndryshuan në ‘bisedime’, ndonëse ato në fund rezultojnë me procese të njëjta.

⁴⁷ Blic. 21 shtator 2011.

Testi kryesor është nëse ne kemi arritur ta menaxhojmë që ta ndryshojmë perceptimin e Serbisë dhe Kosovës për interes vetanak dhe nëse ata e kuptojnë tani më shumë se interesat e tyre gjithashtu varen nga mirëqenia e palës tjetër. Nëse ka progres në palën tjetër, le të jetë por përkundër dëshirës, dhe akoma duke lobuar fuqishëm për ta liruar veten nga ndërvarësia reciproke. A janë Serbia dhe Kosova në të njëjtën varkë? Akoma kemi një logjikë me shumë zero? Po dhe Jo. Prania e një kontesti të hapur e bën më të vërtetë të vështirë vendosjen e një qasje me shumë fitim-fitim. Posa të mbyllet zënka territoriale e veriut të Kosovës si opsion, rregullimi i tij do të sjell një mundësi për realizim kreativ të interesave të përbashkëta. Për më tepër, vendimmarrja multilaterale e Bashkimit Evropian krijon tendenca që të llobohet nga vende të ndryshme kundër njera-tjetres çfarë komplikon dhe zvogëlon ndikimin e zyrës së Zonjës Ashton mbi të dy palët.

A janë Serbia dhe Kosova në të njëjtën anije? Akoma një lojë me shumë-Zero? Po dhe Jo.

Është e natyrshme që Serbia ka për qëllim që të lëvizë më shpejtë drejt BE-së, megjithatë, ekziston perceptimi në Prishtinë se Beogradi po bën më pak se që është minimumi i nevojshëm dhe se pozicioni i ngritur i Serbisë në procesin e saj të integritimit do të jep përfitime të tepërta. Serbisë gjithashtu duhet ti kërkohet që të angazhohet që të mos përdor çfarëdo avantazhi për aderim më të shpejt në BE kundër shtetësisë dhe pranimit të Kosovës. Tani, Serbia më nuk deklaron që Kosova dhe BE-ja janë dy procese të ndara.

Ky proces duhet të përdoret për të bindur Kosovën se pranimi i Serbisë në BE është i mirë për tërë rajonin dhe të bindë Beogradin se suksesi i ngjashëm për Kosovën është në interes të saj. Tani këto argumente nuk kanë ndikim sepse shumica e politikanëve po kërkojnë fitore dhe jo përafrim. Kushtëzimi i vënë nga BE apo në mënyrë bilaterale ka gjasë të ruajë qasjen e 'të qenët në një varkë' dhe të ofrojë nxitje për angazhim me njëri tjetrin, ndonëse politikanët shkurt-pamës janë kundër.

Ngjarje të ndryshme të cilat mund të ndodhin në të ardhmen e afërt mund të vështirësojnë dialogun dhe nëse rezultatet negative mund të parashikohen, ekziston një mundësi e mirë për ti shmangur ato.

Skenarët

Dialogu prek të gjitha fushat, nga ekonomia dhe tregtia, lëvizja e lirë, punësimi dhe politikat sociale, perspektiva e BE-së, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile, shkëmbimeve kulturore apo stabilitetit politik rajonal. Shumë fusha nuk janë trajtuar fare më herët në punim dhe ato mund të rezultojnë me katër rezultate të mundshme që Dialogu mund ta marrë Kosovën dhe Serbinë në fazën tjetër:

1. Skenari Optimist

Serbia dhe Kosova pajtohen mbi të gjitha çështjet të cilat i kanë hapur dhe disa tjera të cilat janë heshtur. Marrëveshja mbi lëvizjen e lirë, tregtinë e lirë dhe integritimin e menaxhuar të kufijve bëhet operacionale, barrikatadat janë hequr me dëshirë nga serbët lokal në veri dhe marrëveshjet janë arritur edhe në telekomunikim, energji dhe bashkëpunimin rajonal (përfaqësimi i Kosovës në forumet rajonale). EULEX është funksional nëpër Kosovë, por ndoshta me përjashtim të gjykatave derisa të merret me këmbimin e regjistrave civil dhe shënimet kadastrale nga Beogradi në Prishtinë.

Nëse largohen barrikatadat dhe përbushen pikat tjera para 9 dhjetorit, Serbia mund të presë të fitojë statusin e kandidatit dhe të marrë premtime për fillim të datës për negociim në mars nëse përmbullen kapituj tjerë deri në atë kohë. Prishtina merr dialogun për liberalizim të vizave dhe marrëdhëniet kontraktuale. Bisedimet do të vazhdojnë në muajt në vazhdim dhe pozitat do të përafrohen, ndonëse publikimi i tyre mund të priste pas zgjedhjeve në Serbi.

2. Skenari pozitiv realist

Derisa skenari i mësipërm mund të jetë tepër ambicioz, optimistët e matur mund të presin që marrëveshja të përmbajë shumicën e pikave të marrëveshjes së parë për tu implementuar dhe vetëm një nga katër çështjet shtesë të hapen dhe marrin dritën e gjelbër (telekomunikimi apo energjia, por ndoshta jo pjesëmarrja e Kosovës në forumet rajonale). Tensionet në veri do të qetësohen dhe barrikadat do të hiqen. Frika nga barrikadat do të mbetet për shkak të tensioneve të larta të cilat do të mbizotërojnë gjatë gjithë periudhës. Nëse eventualisht barrikadat hiqen shtohen gjasat që Serbia ta merr statusin e kandidatit. Kosova do të hap bisedat mbi liberalizimin e vizave dhe do t'i premtohen marrëdhëniet kontraktuale sapo të pajtohen vendet e fundit që rezistojnë brenda BE-së. Qytetarët e të dy vendeve do të kuptojnë se vendet po shkojnë në drejtimin e duhur i cili është shumë i rëndësishëm për fazën pas Dialogut. Bisedimet do të vazhdojnë në muajt në vijim por nuk do të publikohen marrëveshje.

3. Skenari realist negativ

Situata me barrikadat mbizotëron dhe një rrugë pa krye vazhdon. Plasaritja në mes të ekipit negociator të Beogradit dhe serbëve të Kosovës thellohet. Beogradi ushqen ndjenjat nacionaliste dhe heq dorë nga kandidatura. Prishtina mund të fillojë procesin e liberalizimit të vizave, dhe Beogradi mund të merr një tjetër afat kohor shtesë. Në rast se përgjigja Jo drejt Beogradit bëhet me kusht, Beogradi do të ballafaqohet me dy opsione – i pari është që të përpiqet të pajtohet me serbët e Kosovës dhe për këtë ata do të kenë disa kushte në lidhje me bashkëpunimin (pjesa kryesore ndoshta rreth strukturës dhe metodologjisë së ekipit negociator). Tjetri, më pak i mundshëm, është që Beogradi do të heqë dorë nga ambicia kandidaturë dhe të vazhdojë me një retorikë të zgjedhjeve nacionaliste. Pozicioni i Prishtinës do të vështirësohet dhe do të përpiqet që ta implementojë strategjinë e saj në veri.

4. Skenari pesimist:

Ka pak gjasë, por megjithatë është e mundshme që situata të del nga kontrolli dhe rezultojë me vazhdimësi të barrikadave dhe ndikim të shpejtë në jug dhe radikalizim të politikës serbe. Disa liderë nga serbët kosovarë nga veriu kanë paralajmëruar se veriu do ta shpallë pavarësinë nga Kosova, ndonëse ky kërcënim ka gjasa të mbetet vetëm fjalë. Nëse deklarohet, ajo do ti ngrisë bastin dhe do të kërkojë rritje të përfshirjes së Serbisë, Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Kjo me gjasë do të ndalojë të gjitha përpjekjet për përshejtim të Serbisë drejt integritit dhe ndoshta shpie Beogradin në një konflikt të hapur me serbët e Kosovës në të njëjtën mënyrë siç Millosheviçi u ndesh me udhëheqësit e serbëve të Bosnjës në 1994. Kjo padyshim do të ketë një ndikim negativ tek serbët e Kosovës në enklava në jug të Kosovës. Kjo mund të pengojë procesin e zgjerimit të BE-së në tërë rajonin.

Pyetja kryesore është se si të përfshihen serbët e Kosovës nga veriu në proces, nën çfarë kushtesh dhe përmes çfarë kanalesh. Pasi që mundësia për të hapur një kanal të ri politik pas 'dialogut teknik' pamundësohet, duhet të gjenden mënyra që të konsultohen serbët e Kosovës si në veri ashtu edhe në jug. Në të njëjtën kohë, ata duhet të jenë më bashkëpunues dhe mos të pengojnë tërë procesin.

Rekomandime

Një numër i rekomandimeve burojnë nga analiza e mësipërme. Të dy qeveritë duhet ta trajtojnë dialogun e tanishëm si një proces historik i cili ka vlerë në vete dhe jo vetëm në funksion të integritimit në BE. Edhe nëse ai nuk e adreson statusin, ai mund të përmirësojë besimin në mes të dy palëve të kundërta i cili është i nevojshëm para se Serbia dhe Kosova të mund të adresojnë të gjitha dallimet e tyre. Rekomandime tjera janë prezantuar më poshtë të ndara për institucionet përkatëse:

Bashkimi Evropian duhet:

- 1. Të ushtrojë pa humbur kohë ndikimin e tij sa më të madh.** Bashkësia ndërkombëtare duhet ta përdor më tepër ndikimin e saj për të ndihmuar që të dy palët të ripërkufizojnë interesat e veta dhe të bashkëpunojnë. Të dy palët duhet të kenë një pasqyrë të qartë dhe të parashikueshme të karotave dhe shkopinjve që presin varësisht nga politika të cilën ata e zgjedhin. Një qasje më konsistente e BE-së e udhëhequr nga zonja Ashton është esenciale. Mesazhet se situata e tanishme nuk është e qëndrueshme duhet të dërgohen qartë. BE duhet të ndjekë nga afër performancën e palëve veçanërisht në implementimin dhe dizajnimin e duhur të skemës karota dhe shkopi.
- 2. Të bëhen transparente dhe gjithëpërfshirëse të gjitha marrëveshjet.** Asnjë negociatë nuk është plotësisht transparente dhe një shkallë e fshehtësisë është e nevojshme. Atmosfera e fshehtësive rreth dialogut e ka bërë publikun në Serbi dhe Kosovë më dyshues dhe të frikësuar, që pengon ndërtimin e konsensusit. Bërja publike e teksteve të marrëveshjeve të dialogut mund të përfitojë nga më tepër transparence në proces, por ai gjithashtu mund ta bëjë më të vështirë arritjen e marrëveshjeve dhe të eliminojë disa prej “dykuptimësive kreative” që ka mundësuar palët të lëvizin procesin përpara. Megjithatë, transparenca më e lartë sjell përfitime duke shmangur interpretimet arbitrare dhe duke zgjeruar rrjetin e përkrahësve të dialogut. Më tepër transparencë mund ta zgjasë kohën për të arritur një marrëveshje, por edhe mund të ofrojë zgjidhje më afatgjata. Shoqëria civile, parlamentet respektive duhet të përfshihen dhe veçanërisht serbët e Kosovës.
- 3. Vazhdimi i dialogut pas 9 dhjetorit.** Përveç periudhës elektorale, bisedat duhet të vazhdojnë, edhe nëse nuk arrihen marrëveshje apo nëse ato nuk publikohen. Përpjekjet e përtëritura duhet ta përdorin dritaren e mundësisë pas zgjedhjeve për të adresuar të gjitha çështjet tjera të mbetura për normalizim të plotë në mes të Kosovës dhe Serbisë.
- 4. Identifikimi i mekanizmave për parandalimin e rezultateve asimetrike ku Serbia mund ta bllokojë përparimin e Kosovës.** BE duhet përgatisë disa mekanizma të cilët e parandalojnë bllokimin e Beogradit ndaj progresit të Kosovës në BE. BE mund të mos insistojë tani që Serbia formalisht të njohë Kosovën, por duhet të insistojë me siguri për mekanizmat të cilët do të parandalojnë Serbinë në ndikimin e saj në fatin e Kosovës në forumet ndërkombëtare, klubet rajonale dhe iniciativa.
- 5. BE duhet të gjejë mënyra që të konsultojë komunitetin serb në Kosovë.** Për implementim të suksesshëm të marrëveshjeve të dialogut është e nevojshme të dëgjohet zëri i serbëve të Kosovës në proces. Lehtësuesi kryesor i BE-së duhet të takojë dhe bisedojë çështjet e serbëve në tërë Kosovën.

Qeveria e Kosovës duhet të:

- 6. Prezantojë planin për implementimin me faza të Planit të Ahtisarit për komunat veriore të Kosovës.** Të fillojë bisedime direkte me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. Qeveria e Serbisë duhet të dërgojë mesazhe që implementimi gradual i Planit të Ahtisaarit është në interes të gjithë serbëve të Kosovës.

7. **Të krijojë një kanal të komunikimit me figurat kyçe politike serbe.** Një kanal paralel komunikimi duhet të përmirësojë marrëdhëniet e Prishtinës me përfaqësuesit e partive politike në veri. Ky këmbim duhet të diskutojë dhe parandalojë rrezikimin e sigurisë si dhe të vendoset një minimum i besimit për angazhim.
8. **Të prioritizohen rastet gjyqësore ndëretnike dhe të sigurohet maksimumi i suksesit nga decentralizimi.** Kosova duhet më me fuqi të trajtojë dhe gjykojë të gjitha rastet e natyrës ndëretnike dhe të sigurojë që mësimet e nxjerra nga decentralizimi në jug të shërbejnë si shembuj pozitiv për një proces të ngjashëm në veri.

Qeveria serbe duhet të:

9. **Implementojë marrëveshjet për temat të cilat janë pajtuar në raundet paraprake.** Qeveria duhet të përshpejtojë implementimin e tyre dhe të pajtohet për sa më tepër tema shtesë para se të hyjë në periudhën elektorale.
10. **Të plotësojë të gjitha kushtet e kërkuara nga BE-ja dhe kushtet e vëna në mënyrë bilaterale.** Disa nga strukturat serbe në veri duhet të shuhet dhe kjo gjithashtu mund ta justifikojë Beogradin në mos mbajtjen e zgjedhjeve në veri.
11. **Përmirësojë marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe serbëve** në veri dhe krijojë kontakte me përfaqësuesit politik serb në jug.